

MOS U DËSHPRO Ifq. 2

PËRSE ISLAMI DHE TEVHIDI? Ifq. 6

ADHURIMI I MELAJKEVE DHE
OBLIGIMET E TYRE Ifq. 12

Dëlirje & Edukim

MAJ 2011 | JUMADA EL-EVEL - JUMADA EL-AHIR 1432 | NR. 25 | ÇMIMI 1€

REVISTË MUJORE FETARE EDUKATIVE KULTURORE SHKENCORE



MËNYRAT E PËRHAPJES SË ATEIZMIT MODERN

Megjithatë, pavarësisht nga këto forca, të cilat po e luftojnë fenë, feja islame ende dërgon rreze ndriçuese, ende vazhdon të prodhojë fuqi, miliona njerëz janë kthyer e vazhdojnë të kthehen në fe, e kanë bërë atë fenë preokupim kryesor, e mbrojnë dhe e përhapin anekënd globit. **fq. 10**

"Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim)" En Nisa 36

Libraria Vlera

Gjilan

*Libraria Vlera, gjendet përballë Fakulltetit të
Edukimit 60000 Gjilan*



Në librari kemi edhe literaturë për huazim dhe lexim të tyre...

*"Përkufizojë vetën tënde me ata që
lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje,
e që kanë për qëllim kënaqësinë
(razinë) e Tij..." El-Kehf:28*

SI THIRRËSI NË FE ASHTU EDHE I THIRRURI DUHET TË MBËSHTETEN NË ALLAHUN E MADHËRUAR: THIRRËSI DUHET TË JETË I KUJDESSHËM T'I THËRRASË MUSLIMANËT TEK AJO QË I AFRON ME MËSHIRËN E ALLAHUT DHE QË I LARGON NGA HIDHËRIMI I TIJ, T'U JAPË SHPRESA PËR SHPËTIM, PËR MBULIM NGA MËSHIRA E KRIJUESIT, POR GJITHNJË DUKE ECUR PARALEL MES SHPRESËS DHE FRIKËS (EDITORIALI)


“ËSHTË DETYRA JONË QË T'I NDIHMOJMË BESIMTARËT.”

ER RUM: 47 (POZITA E NJËSHMËRISË NË JETËN E MUSLIMANIT)

O UMMET ISLAM! URDHËRIMI NË TË MIRË DHE NDALIMI NGA E KEQJA ËSHTË DETYRA DHE OBLIGIMI YNË NGASE ALLAHU I LARTËSUAR THOTË: “JU JENI POPULLI MË I MIRË I DALË PËR NJERËZIMIN SEPSE JU URDHËRONI QË TË BËHEN VEPRA TË MIRA, I NDALONI TË KËQIJAT DHE BESONI ALLAHUN.” ALU IMRAN: 110 (URDHËRIMI NË TË MIRË DHE NDALIMI NGA E KEQJA)

SIGURISHT QË NJË PJESË E DITURISË ËSHTË E PËRBASHKËT DHE AJO ËSHTË DIJA E OBLIGUESHME NË PËRMIRËSIMIN E BESIMIT, ADHURIMIT DHE ETIKËS, MIRËPO KA METODA QË I PËRSHTATEN FEMRËS NË ROLIN E JETËS SË SAJ DHE KA METODA QË I PËRSHTATEN MASHKULLIT. (FEMRA DHE KURTHET E ARMIKUT)

“AJO QË E KENI PRANË VETËS ËSHTË E PËRKOHSHME, E AJO QË ËSHTË TE ALLAHU ËSHTË E PËRJETSHME...” EN-NAHL:96 (MIRËSIA E DUASË)



Kryeredaktor:

Unejs MURATI

Zv. Kryeredaktor:

Mr. Fidan XHELILI

Anëtarët e revistës:

Adem AVDIU

Sabahudin SELIMI

Xheladin LEKA

Bashkëpunëtorët:

Bali SADIKU

Fehmi DALIPI

Lirim SADIKU

Namik VEHAPI

Shuajb REXHA

Redaktor gjuhësor:

Arian KOÇI

Boton:

Shtëpia botuese

Atik

Gjilan, Republika e Kosovës

Tirazhi: 1000

Adresa:

Rr. M. Idrizi p.n 60000 Gjilan

Republika e Kosovës

E-mail: delirjedheedukim@gmail.com

PËRMBAJTJA

EDITORIALI

Unejs MURATI

Mos u dëshpëro 2

Prof.Dr. AbduRrezak EL BEDER

Pozita e njëshmërisë në jetën e muslimanit 4

Prof.Dr. AbduRrezak EL BEDER

Përse Islami dhe tevhidi? 6

Mahmud ABDUL-HAMID

Mënyrat e përhapjes së ateizmit modern 10

Dr.Muhamed ibën Abdulvehab EL-AKIL

Adhurimi i melaikëve dhe obligimet e tyre 12

Abdul-Aziz ibën Abdil-lah ibën BAZ

Gjykimi për kërkimin e ndihmës nga xhinët dhe shejtanët
dhe zotimit ndaj tyre -II- 17

Ebu Islam, Salih ibën Taha ABDULVAHID

Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja 23

Adem AVDIU

Përgjigjet e qarta ndaj dyshimeve me të cilat argumentojnë
lejimin e Mevludit 29

Dr Abdullah ibën Vekil ESH SHEJH

Femra dhe kurthet e armikut -III- 32

Prof.Dr. AbduRrezak EL BEDER

Mirësia e duasë 36

NDIHMO REVISTËN

Nr. i llog.: 1150-138922-0101-09

ProCredit Bank of Kosovo

Swift Code: MBKORS22

Gjilan, Republika e Kosovës



MOS U DËSHPËRO

Nuk ka njeri pa mëkate, nuk ka njeri pa gabime, nuk ka njeri pa mërzi, nuk ka njeri pa të meta, por më i miri është ai që pendohet, ai që di të menaxhojë situatat e rënda dhe sprovat që e godasin.

E falënderoj Allahun e Madhëruar, Mëshiruesin, Mëshirëplotin, Atë që mëshiron me mëshirën e gjerë, me mëshirën e posaçme për besimtarët. Të mëshira e Tij shpresojnë të sinqertët, ndërsa prej dënimit të Tij kërkojnë mbrojtje të devotshmit.

Muslimani jeton mes frikës dhe shpresës, nuk e tepron në frikë dhe dëshpërim, është neutral, as nuk e tepron në të shpresuarit dhe të bëjë mëkate.

Jeta kalon me kënaqësi e lumturi të ndryshme, dikush ka jetë të gjatë e dikush më të shkurtër, por gjithçka është caktuar nga Allahu i Mëshirshëm.

Dikush ka një jetë me sprova e vuajtje të ndryshme, që i përsëriten njëra pas tjetrës. Dikush tjetër është i fortë dhe i përgatitur që të ballafaqohet me to e të mos dëshpërohet, ndërsa dikush tjetër gjindet në situata jo të

mira që Allahu nuk është i kënaqet me të.

Muslimani i sinqertë synon përherë kënaqësinë e Allahut, duke mos u preokupuar shumë me problemet dhe sprovat e tij, pasi ka një qëllim të lartë, i cili është takimi me Allahun e Mëshirshëm në xhennetet e Tij.

Dikush dëshpërohet nga sëmundja që i ka rënë, dikush nga varfëria, dikush nga dashuria, dikush nga ndarja prej dikujt e dikush tjetër nga mosarritja e sukseseve të planifikuara.

Të gjithë i humbin shpresat dhe dëshpërohen në atë masë sa që largohen krejtësisht nga planet dhe projektet e tyre; qofshin ato thirrja në Allahun, projektet e biznesit apo planifikime familjare për jetë të lumtur islame.

Nuk ka njeri pa mëkate, nuk ka njeri pa gabime, nuk ka njeri pa mërzi, nuk ka njeri pa të meta, por më i miri është ai që pendohet, ai

që di të menaxhojë situatat e rënda dhe sprovat që e godasin.

Të dëshpërohesh nga jeta për shkak të këtyre gjërave është kundërshtim i fjalës së Allahut:

“...dhe mos e humbni shpresën për mëshirën e Allahut. Shpresën të mëshira e Allahut nuk e humb askush përveç jobesimtarëve.” Jusuf: 87

Shiko në çfarë niveli është ai që humb shpresën për mëshirën e Allahut, ngase ka thyer urdhrin e Allahut, të Mëshirshmit, i Cili na ka urdhëruar të mos e humbim shpresën të mëshira e Tij.

“E kush mund ta humbë shpresën për mëshirën e Zotit të vet, përveç atyre që janë të humbur?” El Hixhr: 56

Një njeri i tillë pa dyshim që ka devijuar me një devijim të skajshëm.

Si thirrësi në fe ashtu edhe i thirruri duhet të mbështeten në Allahun e Madhëruar: thirrësi duhet të jetë i kujdesshëm t'i thërrasë muslimanët tek ajo që i afron me mëshirën e Allahut dhe që i largon nga hidhërimi i Tij, t'u japë shpresa për shpëtim, për mbulim nga mëshira e Krijuesit, por gjithnjë duke ecur paralel me shpresës dhe frikës.

Imam Darimiu transmeton se Aliu radijAllahu anhu ka thënë: "Dijetari i vërtetë është ai që nuk ua humb të tjerëve shpresat të mëshira e Allahut, nuk ua thjeshtëson dhe lehtëson gjërat mëkatarëve dhe nuk i siguron ata nga dënimi i Allahut."

Si mund të dëshpërohesh kur pas vështirësisë vjen lehtësimi, pas çdo nate lind dielli, pas çdo thatësie vjen gjelbërimi, pas çdo frike vjen qetësia e pas çdo mundi vjen çlodhja?!

Si mund të jesh i dëshpëruar kur Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Fitorja vjen me durim, lehtësimi vjen me vështirësi. E,*

pas çdo vështirësie vjen lehtësimi."^[1]

Ki mendim të mirë për Allahun, pasi mendimi i mirë ndaj Allahut të drejton drejt kryerjes së urdhrave të Tij, të afron me xhenetin e Allahut dhe të largon nga xhehenemi. Sufjan eth Thevri ka thënë: "Ditën e Gjykimit, nëse do të më gjykonte nëna ime, nuk do të pranoja sepse Allahu është më i mëshirshëm me mua sesa nëna ime."

Muslimani duhet të jetë i hapur në jetë, të jetë zemërçelë, të pranojë justifikimet e tjerëve, të pranojë gabimet e kujtdo, të mundohet t'i këshillojë dhe t'u japë ide të reja gabimtarëve, duke i ndihmuar në tejkalimin e situatave me butësi dhe urtësi të madhe.

Tabarani transmeton nga Sh'abiju, ky nga Bishri, se ka dëgjuar Ibën Mes'udin radijAllahu anhu duke thënë: "Ajeti më përgëzues në Kur'an është fjala e Allahut: ***"Thuaj: O robërit e Mi, që i keni bërë keq vetes me gjynahe, mos e humbni shpresën nga mëshira e Allahut! Allahu, me siguri, i fal të gjitha gjynahet. Vërtet, Ai është Falësi i madh dhe Mëshirëploti."*** Ez Zumer: 53

Të nderuar gjyshër, prindër, bashkëshortë, motra dhe fëmijë, mos e humbeni shpresën nga mëshira e Allahut! Allahu fali njeriun që vrau 99 veta, Allahu e fal atë që pendohet dhe gëzohet kur robi kthehet tek Ai duke kërkuar falje dhe e madhëron Atë.

Mos harroni se mëshira e Allahut e kaplon hidhërimin e Tij.

Unejs MURATI
Gjilan / Kosovë

[1] Transmetojnë Ahmedi dhe Tirmidhiu. Hadithi është i saktë.



POZITA E NJËSHMËRISË NË JETËN E MUSLIMANIT

Me tevhid njeriu shijon jetën e vërtetë prej së cilës Allahu është i kënaqur, shijon fitoren e sigurt, kurse pa tevhid bën jetë kafshësh, ashtu siç ka thënë edhe Allahu në Kur'an: "A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër veçse si bagëti. Madje ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë." El Furkan: 44

Qëllimi final dhe më madhor i besimtarit është tevhidi, njësimi i Allahut, Zotit të qiellit dhe të tokës, duke e besuar dhe njësuar thellësisht Allahun e Madhëruar me përkushtim, përlulje dhe modesti të lartë, duke shijuar inkurajimin dhe frikësimin, shpresën dhe frikën, me ruku dhe sexhde, me sinqeritetin më të madh dhe duke u larguar nga politeizmi tërësisht. Ky është edhe qëllimi kryesor i krijimit të njeriut nga Allahu i Madhëruar, siç thotë Allahu në Kur'an, në suren Edh Dharijat: **"Nuk i krijova xhinët dhe njerëzit pos që të më adhurojnë Mua."** Ky është qëllimi për të cilin Allahu ka dërguar të Dërguarit dhe ka zbritur librat fisnikë.

"Çdo populli Ne i çuam një të Dërguar (që u thoshte): "Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!" En Nabl: 36

"Ne nuk kemi nisur asnjë të Dërguar para teje që të mos i kemi shpallur se "s'ka zot tjetër (që

meriton adhurimin) përveç Meje, andaj më adhuroni (vetëm) Mua!" El Enbija: 25

Me tevhid njeriu shijon jetën e vërtetë prej së cilës Allahu është i kënaqur, shijon fitoren e sigurt, kurse pa tevhid bën jetë kafshësh, ashtu siç ka thënë edhe Allahu në Kur'an: **"A mendon ti se shumica e tyre dëgjojnë dhe kuptojnë? Ata nuk janë tjetër veçse si bagëti. Madje ata janë edhe më të shmangur nga rruga e drejtë."** El Furkan: 44

Kush ka humbur tevhidin është i vdekur edhe nëse ecën ende mbi tokë, ndërsa ai që ka tevhid ka ringjallur dhe vërtetuar jetën e vërtetë. Allahu i Madhërishëm në Kur'an thotë: **"A barazohet i vdekuri që Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë..."** El En'am: 122, d.m.th. e ngjallëm me besim, njëshmëri në Allahun. Allahu i Madhëruar në Kur'an thotë: **"O besimtarë! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit kur**

ju thërret drejt asaj që ju jep jetë.” El Enfal: 24

Me njëshmëri arrihet siguria e vendit dhe e trupit, të cilën Allahu na e përshkruan kështu: *"Sa për ata që besojnë dhe nuk e molepsin besimin e tyre me padrejtësi (idhujtari), pikërisht atyre u takon siguria dhe ata janë të udhëzuar.” El En'am: 82*

"Allahu u ka premtuar atyre prej jush, që besojnë dhe që bëjnë vepra të mira, se do t'i bëjë mëkëmbës në Tokë, ashtu siç i ka bërë ata para tyre dhe që do t'ua forcojë fenë e tyre, me të cilën Ai është i kënaqur dhe që frikën do t'ua shndërrojë në siguri. Le të më adhurojnë Mua e të mos më shoqërojnë asgjë (në adhurim).” En Nur: 55

Me tevhid ose njëshmëri arrihet lumturia dhe qetësia e plotë. Allahu në Kur'an thotë: *"Cilindo mashkull apo femër që kryen vepra të mira, duke qenë besimtar, Ne do ta bëjmë që të kalojë jetë të bukur dhe do ta shpërblejmë sipas veprave më të mira, që ka bërë.” El Nahl: 97*
"Kushdo që i kthen shpinën Këshillës Sime, do të ketë jetë të mjeruar dhe Ne, në Ditën e Kiametit, do ta ringjallim të verbër.” Ta Ha: 124
"Ne nuk ta kemi shpallur Kur'anin ty (o Muhamed) për të të munduar.” Ta Ha: 2, por që të jetë i lumtur bashkë me të gjithë ata që e pasojnë.

Me tevhid largohet ndryshku dhe përjashtohen dyshimet e idetë e çoroditura, arrihet qetësia shpirtërore, ngrohja dhe prehja. Allahu në Kur'an ka thënë: *"Thuaj: "Kërkoj mbështetje te Zoti i njerëzve, Sundimtari i njerëzve, i Adhuruari (i vetëm me të drejtë) i njerëzve.” Ky është tevhidi, njësimi i Allahut, "nga sherri i djallit cytës që fshihet (pasi cyt), e që hedh dyshime në gjokset e njerëzve, (qoftë ai djall) prej xhindeve apo njerëzve!” En Nas: 1-6*

Me tevhid ose njëshmëri dëbohet shejtani dhe nuk i mbetet vend aty ky njësohet Allahu. Kur thirret ezani ai largohet me të

shpejtë. Kur'ani i gjithi është tevhid dhe madhësim i Allahut. Ajetul Kursij është ajeti i njësimi të Allahut dhe qartësues i argumentimit për njësim. Nëse besimtari e lexon ajetul Kursijen kur shkon në shtrat, mbetet në mbështetjen dhe mbrojtjen e Allahut nga shejtani derisa të zgjohet.

Me tevhid ose njëshmëri besimtari ruhet nga kurthet e fallxhorëve. Allahu në Kur'an thotë: *"Allahu, në të vërtetë, i mbron besimtarët. Ai nuk i do tradhtarët mohues.” El Haxh: 38*

"Është detyra Jonë që t'i ndihmojmë besimtarët.” Er Rum: 47

Me tevhid apo njëshmëri robi vjel të mirat e kësaj bote dhe të ahiretit, lumturinë e saj dhe shpëtimin në ahiret, ngase Allahu i Madhërisëm ka caktuar se lumturia dhe rehatia është për ata që besuan dhe ishin të bindur në tevhid gjatë jetës së tyre. Allahu në Kur'an thotë: *"Vërtet, punëdrejtët do të jenë në xhennet.” El Infitar: 13*

Me tevhid muslimani obligohet të fillojë të thërrasë e të këshillojë të tjerët për Allahun e Madhëruar. Allahu në Kur'an thotë: *"Por këshillo, se vërtet këshilla u bën dobi besimtarëve. Xhindet dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të më adhurojnë.” Edh Dharijat: 55-56*

Lusim Allahun e Madhëruar të na ringjallë para Tij të devotshëm dhe me njëshmëri të pastër e të na ruajë nga politeizmi dhe llojet e tij!

Prof.Dr. AbduRrezak EL BEDER

*Përshtati: Unejs MURATI
Gjilan / Kosovë*



PËRSE ISLAMI DHE TEVHIDI?

Allahu, Krijuesi i Madhërishëm, nuk i ka krijuar krijesat kot. Allahu az-ze ve xhel-le thotë: "Mos vallë keni menduar që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk do të ktheheshit te Ne (për t'ju gjykuar)?" El-Mu'minun: 115

Islami dhe tevhidi janë mjet për të arritur lumturinë e të dyja botëve. Këtë e di vetëm ai që e ka vërtetuar këtë dhe ka sinqeritet në Islam dhe tevhid. Allahu az-ze ve xhele nuk i krijoi krijesat kot. As njeriu nuk e braktis pasurinë, shtëpinë dhe mallin për diçka të kotë. Si mund ta mendojmë këtë për Zotin e botëve az-ze ve xhel-le? Ai që të ka krijuar duhet të adhurohet, të njësohet në adhurim, të mos i bëhet ortak as ndonjë melek i afërt e as ndonjë Pejgamber i dërguar, as njerëz të mirë, as ngurtësi, as pemë e

as gurë etj.

Nga natyrshmëria e njeriut është që të dëshirojë pavarësimin nga të tjerët. E si mund të jetë për Atë që të ka krijuar ty, qiellin dhe tokën, të furnizoi, të dhuroi dhunti dhe të vlerësoi?

Allahu i Lartësuar thotë: **"Atëherë, a është njësoj si Ai që krijon si ai që nuk krijon?"** En-Nahl: 17

Si të adhurohet ai që nuk mund të krijojë as edhe një mizë, madje nëse miza i merr diçka, ai nuk mund t'ia marrë, siç thotë Allahu i Madhëruar: **"O njerëz, është sjellë një shembull,**

*andaj dëgjojeni atë: idhujt që ju adhuro-
roni në vend të Allahut nuk mund të
krijojnë as edhe një mizë, edhe nëse
bashkohen të gjithë për këtë. E, nëse
miza u merr atyre diçka, ata nuk do të
mund t'ia marrin. I dobët është
përgjëruesi (adhuruesi), por edhe ai të
cilit i përgjërohet (idhulli).” El-Haxh: 73*

Lënda që merr miza shndërrohet në
lëndë tjetër dhe sado e madhe të jetë
vlëra nga e cila është marrë ajo gjë,
nuk mund të kthehet në formën e sajë
të mëparshme.

Allahu, Krijuesi i Madhërishtëm, nuk i
ka krijuar krijesat kot. Allahu az-ze ve
xhel-le thotë: *"Mos vallë keni menduar
që Ne ju kemi krijuar kot dhe që nuk
do të ktheheshit te Ne (për t'ju
gjykuar)?"* El-Mu'minun: 115

Allahu, Krijuesi i Madhëruar, pose-
don emra dhe cilësi që duhet të dihen.
Ai është që dëgjon, sheh, i Gjithëdi-
jshëm, i Madh, nuk i mungon ditur-
isë së Tij asgjë që gjendet në tokë dhe
qiell.

Madhështia e krijimit të krijesave
aludon për madhërinë e Krijuesit az-
ze ve xhel-le, prandaj është obligim që
të besojmë se vërtetë dëgjimi, shikimi,
dituria, madhëria e Krijuesit, të gjitha
këto kanë pozitë më të madhe se
dëgjimi, shikimi, dituria, madhëria e
krijesës dhe nga kjo pason shpërblimi
dhe ndëshkimi, siç thotë Allahu az-ze
ve xhel-le: *"Kush ka bërë ndonjë të*

*mirë, qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë
atë. E, kush ka bërë ndonjë të keqe,
qoftë sa një thërrmijë, do ta shohë atë.”*

Ez-Zelzele: 7-8

Nuk ka mundësi që një komandant
ushtrie ta shikojë ushtrinë e tij duke
thyer urdhrin e tij, duke u tallur me të
e pastaj të mos marrë ndonjë masë
ndëshkimi ndaj tyre. E si do të jetë
çështja me Zotin, Krijuesin e
gjithçkaje? Prej shkaqeve më të mëdha
të dënimit të shpirtit dhe paretisë së
tij është mosnjësimi i Krijuesit az-ze
ve xhel-le dhe mëkati. A je ti i qetë
nëse dikush e thyen dhe e kundërsh-
ton urdhrin tënd?

Prej këtyre cilësive është fjala, me anë
të së cilës qartësohet ajo që dëshiron
Krijuesi nga krijesat e Tij dhe sqaro-
het ajo që do dhe urren Ai. Në
meditim të fjalës së Tij fitohet sekreti
i lumturisë së dy botëve, kurse harrimi
i Tij sjell mjerim dhe dënim.

Nga frytet e besimit në emrat e bukur
të Allahut dhe cilësitë e Tij të larta
është përqendrimi fshehtëzimi dhe pub-
likisht. Adhuroje Allahun az-ze ve
xhel-le si të jesh duke e parë sepse
nëse ti nuk e sheh Atë, Ai të sheh ty.
Njerëzit kanë kërkuar lumturinë në
pasuri, gra, epshe, ushqim, por nuk e
kanë gjetur sepse mëkatuan. Pastaj i
dënoi ata për arsye se nuk u kushtuan
rëndësi gjërave që e kënaqin Allahun

az-ze ve xhel-le, nuk u kujdes për ushqimin e zemrave dhe shpirtrave të tyre, ushqimi i barkut dhe organeve gjenitale nuk përjashtohet nga ushqimi i zemrës dhe shpirtit. I Lartësuar thotë: ***"Ata që besojnë dhe zemrat e të cilëve, kur përmendet Allahu, qetësohen. Vërtet zemrat qetësohen me përmendjen e Allahut."*** Err-Rra'd: 28

Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Shembulli i atij që e përmend Allahun dhe i atij që nuk e përmend Allahun është si shembulli i të gjallit dhe të vdekurit."*^[1]

A është dikush që na njofton për ligjin e Allahut az-ze ve xhel-le? Po! Allahu az-ze ve xhel-le dërgoi Pejgamberë përgëzues dhe qortues, të cilët qartësuan urdhrat dhe ndalesat e Allahut az-ze ve xhel-le. Pejgamberët kishin me vete argumentet e Allahut të Lartësuar, prandaj besimi në Pejgamber është obligim dhe respektimi i tyre është i patjetërsueshëm, mohimi i tyre është mohim në Allahun dhe mosrespektimi i tyre është mosrespektim i Zotit të botëve.

Nuk lejohet që njerëzit të bëjnë dallime mes Pejgamberëve. I Madhëruari thotë: ***"Ne nuk bëjmë dallim mes asnjërit prej të Dërguarve të Tij."*** El Bekare: 285. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve

sel-lem na ka urdhëruar t'i besojmë të gjithë Pejgamberët e Allahut az-ze ve xhel-le. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem është vula e Pejgamberëve, është Pejgamberi i fundit; mohimi në njërin nga Pejgamberët është mohim në Allahun az-ze ve xhel-le dhe mohuesi do të jenë përgjithmonë në zjarr.

Allahu i Madhëruar i ka shpjeguar në librin e Tij dhe përmes gjuhës së të Dërguarit të Tij sal-lAllahu alejhi ve sel-lem të gjitha obligimet e domosdoshme, me në krye njësimin e Allahut az-ze ve xhel-le në adhurim, bindje, namaz, agjërim, zekat, haxh, frikë, shpresë, inkurajim, kërcënim, dua. Ai qartësoi shtyllat, farzet, obligimet, sunnetet, hallallin dhe haramin si dhe moralin e sjelljen e mirë që njeriu duhet të ketë. Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Jam dërguar për përsosjen e virtyteve të larta."*^[2] Në një hadith tjetër thotë: *"Më i zgjedhuri mes jush është ai me moralin më të mirë."*^[3] Islami e çmon moralin dhe sjelljet e mira të njeriut që edukohet me edukim të pastër islam dhe me optimizëm, duke qenë çelës për të mirë dhe mbyllës i së keqes.

Islami na ka treguar se si duhet të sillet njeriu me vëllanë e tij, pa marrë parasysh se çfarë bindjeje dhe feje ka.

[1] Transmeton Buhariu, nr. 6407.

[2] Transmeton Buhariu.

[3] Transmetojnë Buhariu, nr. 3559, dhe Muslimi, nr. 2321.

[4] Transmetojnë Ibën Ebi Shejbeh në Musanef dhe Ibën Ebi Hatim në tefsir dhe të tjerët.

Në një hadith Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *"Jepuni sadaka ihtarëve të feve."*^[4] Lejohet pra dhënia e sadakasë vullnetare për ithtarët e feve.

Feja e tevhidit është feja e rehatisë, lumturisë, mëshirës, butësisë. Ajo e ndaloi vrasjen e atyre që janë të siguruar nga shteti si dhe mosfrikësimin e tyre, ua tërhoqi vërejtjen atyre që bëjnë shpërthime dhe fusin frikë te njerëzit, i largojnë ata nga feja, i pengojnë nga tevhidi dhe besimi. Madje ne jemi të urdhëruar për t'i ftuar në Islam me butësi, duke ua qartësuar mirësitë e kësaj feje dhe veçoritë e saj të mëshirës, sigurisë, shpëtimit dhe fitimit.

Allahu az-ze ve xhel-le i tha Musait dhe vëllait të tij alejhima selam:

"Shkoni te Firaoni! Ai, me të vërtetë, i ka shkelur të gjithë kufijtë. Flitni atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet e frikësohet." Ta Ha: 43-44

Njeriu duhet të pasojë Pejgamberin sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, për të cilin Allahu az-ze ve xhel-le ka thënë: ***"Dhe Ne nuk të kemi dërguar ty (o Muhamed) veçse si mëshirë për botët."*** El-Enbija: 107, që do të thotë i mëshirshëm me njerëzit, kafshët, shpezët dhe gjithçka.

Allahu az-ze ve xhel-le ia ka ndaluar padrejtësinë Vetvetes dhe ua ndaloi

edhe robërve të Tij. Transmetohet nga Ebu Dherri, Allahu qoftë i kënaqur me të, se Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lam ka thënë atë që e ka transmetuar nga Allahu i Madhëruar: *"O robërit e Mi! Vërtet Unë ia ndalova Vetes Sime padrejtësinë dhe e bëra mes jush të ndaluar, ndaj mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit!"*^[5] Allahu i Lartësuar gjithashtu thotë: ***"Lutjuni Zotit tuaj përulshëm dhe ngadalë! Njëmend, Ai nuk i do ata që e kalojnë kufirin."*** El-A'raf: 55


O njeri! Ty të mbetet që ta adhurosh Allahun me sinqeritet, të ndjekësh rrugën e drejtë dhe të udhëzimit. Nëse je besnik në këtë, Allahu do të të udhëzojë.

Lusim Allahun az-ze ve xhel-le që të na bëjë nga të udhëzuarit dhe kërkojmë mbrojtje nga Allahu az-ze ve xhele që të mos na bëjë nga zul-lumqarët dhe tiranët!

Prof.Dr. AbduRrezak EL BEDER

*Përshtati: Fehmi DALIPI
Gjilan / Kosovë*

[5] Transmeton Muslimi, 2577.



Ateizmi është bërë një fenomen epidemik vetëm pasi çifutët bënë plane për ta përhapur mes njerëzve dhe për ta bërë doktrinë falë organizatave dhe shteteve të mëdha që e përqaftuan atë.

Falënderimi i qoftë Allahut, paqja dhe bekimi qofshin mbi të Dërguarin e Allahut. Ateizmi asnjëherë në historinë njerëzore nuk ka qenë tipar i dukshëm i një bashkësie njerëzore apo doktrinë e përkrahur nga organizata dhe shtete, por një fenomen individual i rrallë. Rreth tij bashkoheshin disa grupe të vogla amatorësh të krimit, padrejtësisë dhe agresionit. Mund të ketë qenë vetëm ndonjë tendencë e ndonjë njeriu të mashtruar, që ka mohuar Zotin dhe e ka shpallur veten për Zot dhe njerëzit e kanë adhuruar atë përveç Allahut të Lartësuar.

Ateizmi është bërë një fenomen epidemik

vetëm pasi çifutët bënë plane për ta përhapur mes njerëzve dhe për ta bërë doktrinë falë organizatave dhe shteteve të mëdha që e përqaftuan atë.

Në Protokollin e katërt nga "Protokollet e djajve sionistë" thuhet: "Ne duhet të heqim mendimin për Zotin nga mendjet e njerëzve "të lajthitur" e injorantë^[1] dhe në vend të tij të vëmë llogaritje matematikore dhe dëshira materialiste."

Përhapja e ateizmit gjatë shekujve 19 dhe 20 nga çifutët, nga njerëzit e shitur për ta dhe nga agentët e tyre është bërë në dy mënyra.

[1] Me fjalën të lajthitur dhe injorantë ata kanë për qëllim çdo njeri tjetër përveç çifutëve. Rrënja e këtij nënçmimi ndaj të tjerëve rrjedh nga bindja e tyre djallëzore se kinse ata qenkan populli i zgjedhur i Allahut, ndërsa çdo njeri tjetër është vetëm shërbëtor dhe rob i tyre (sh.p.).

Mënyra e parë ka qenë ngritja e motos së racionalizmit dhe sekularizmit, që dominoi fuqishëm në mendimin perëndimor. Mënyra e dytë ka qenë përhapja e marksizmit me gjithë filozofinë që përmban, motot, programet dhe gjitha llojet e kurtheve dhe mashtrimeve të tij.

Për të përhapur ateizmin kanë përdorur disa metoda, disa prej të cilave janë:

1. Njolloosja e famës së praktikueseve të fesë dhe udhëheqësve fetarë me anë të shpifjeve, siç thuhet në protokollin e shtatë: "Jemi lodhur shumë që të rrëzojmë dinjitetin e praktikueseve të fesë në sytë e njerëzve, por kemi arritur të dëmtojmë misionin e tyre, i cili ishte pengesë serioze në rrugën tonë." Në protokollin e nëntë thuhet: "Ne e kemi mashtruar brezin e ri dhe e kemi bërë të prishur dhe të kalbur duke i shërbyer parime dhe teori për të cilat e dinim shumë mirë se janë plotësisht gënjeshtra dhe tri-llime, por ishim ne ata që ua serviram atyre."

2. Parandalimi i lëvizjeve fetare në vend, sado të dobëta, duke punuar vazhdimisht dhe me vigjilencë për të zhdukur çdo mision të fesë, duke e goditur atë me dhunë dhe pa mëshirë. Meqë feja luan rol të rëndësishëm në ndërtimin e popujve, ata punuan ta rrethojnë atë nga çdo anë duke e akuzuar me shpifje të rënda dhe duke i larguar njerëzit nga ajo me çdo mënyrë.

3. Inkurajimi i shkrimtarëve ateistë, duke u dhënë atyre të gjitha liritë që të kundërshtojnë apo të abuzojnë me shkrimet e tyre ndaj ndjenjave fetare.

4. Fokusimi në mendjet e njerëzve se koha e Islamit ka marrë fund dhe prej tij në ditët e sotme kanë mbetur vetëm adhurimet formale.

5. Ndërprerja e lidhjeve fetare midis popujve dhe krijimi i lidhjeve të tjera mes tyre.

6. Mbulimi i jetës me gjëra që e prishin fenë, si: tregime, skena, ligjërata, gazeta, lajme, libra që nxisin në ateizëm dhe bëjnë thirrje në të, tallen me fenë dhe pasuesit e saj dhe bëjnë thirrje që të ekzistojë vetëm shkenca.

7. Shkatërrimi i vlerave fetare dhe shpirtërore me pretendimin se në to ka defekte dhe të meta dhe se nuk janë në pajtim me mendjen apo kohën që jetojmë.

Megjithatë, pavarësisht nga këto forca, të cilat po e luftojnë fenë, feja islame ende dërgon rreze ndriçuese, ende vazhdon të prodhojë fuqi, miliona njerëz janë kthyer e vazhdojnë të kthehen në fe, e kanë bërë atë fenë preokupim kryesor, e mbrojnë dhe e përhapin anekënd globit.

Miliona njerëz në mbarë botën konvertohen në Islam, i shfaqin haptazi mësimet e tij dhe thërrasin të tjerët në të. Të vërtetën ka thënë Allahu kur thotë: **"Mbeturinat hidhen, ndërsa ajo që u shërben njerëzve mbetet në tokë."** *Er-Ra'd: 17*

Mahmud ABDUL-HAMID

*Përshtati me disa shkurtesa dhe ndryshime të vogla:
Xheladin LEKA
Zyrih / Zvicër*



ADHURIMI MELAIKEVE DHE OBLIGIMET E TYRE

TEMA E PARË: ADHURIMET MË TË RËNDËSISHME TË MELAIKEVE

Melaiket i duan dhe ata e duan Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe janë armiq të atij që armiqësohet me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Melaiket i duan shokët e Pejgamberit sal-Allahu alejhi ve sel-lem dhe armiqësojnë dhe urrejnë ata që i shajnë dhe armiqësojnë sahabët.

LUTJET E VEÇANTA TË MELAIKEVE

Kemi folur në numrin e kaluar se si melaiket luten dhe kërkojnë falje për besimtarët. Ata gjithashtu urrejnë jobesimtarët, i mallkojnë ata dhe zbresin nga qielli që t'i dënojnë. Kjo njëkohësisht është edhe ndihmesë për besimtarët kundër jobesimtarëve, siç ka ndodhur në disa beteja të Pejgamberit sal-Allahu alejhi ve sel-lem. Argumentet për këtë janë të shumta në Kur'an dhe Sunnet.

Nga këto argumente është fjala e Allahut:

"Ata të cilët mohuan dhe vdiqën si jobesimtarë, kundër tyre është mallkimi i Allahut, i engjëjve dhe i të gjithë njerëzve." El-Bekare: 161

Gjithashtu: *"E si ta udhëzojë Allahu një popull që pas besimit të tyre u bënë jobesimtarë dhe pasi dëshmoi se i Dërguari është i vërtetë dhe pasi t'u kenë ardhur atyre argumente të qarta? Allahu nuk ia mundëson udhëzimin e Vet pop-*

ullit zullumqar. Ndëshkimi i të tillëve është mallkimi nga Allahu, nga engjëjt dhe nga gjithë njerëzimi tok." Alu- Imran: 86-87

Ky mallkim i melaikeve për personin e mallkuar e shoqëron atë deri në Ditën e Kiametit, Allahu na ruajttë. Allahu thotë: *"E kush është më mizor se ai që trillon gënjeshtër për Allahun? Të tillët paraqiten para Zotit të tyre, e dëshmitarët thonë: "Këta ishin të cilët gënjyen ndaj Zotit të tyre, pra mallkimi i Allahut qoftë kundër mizorëve, të cilët pengojnë nga rruga e Allahut dhe përpiqen ta shtrembërojnë, mu ata janë që nuk e besojnë botën tjetër."* Hud: 18-19

Dëshmitarët e përmendur në këtë ajet janë engjëjt, thuhet se janë edhe të Dërguarit, Pejgamberët dhe njerëzit e tjerë si dhe xhinët. Pika e rëndësishme që morëm nga ajeti është se melaiket i mallkojnë jobesimtarët Ditën e Gjykimit. Allahu na ruajttë!

Kurtubiu thotë: "Dëshmitarët në këtë ajet janë melaiket ruajtës dhe këtë mendim e përmend nga Muxhahidi, A'meshi dhe të tjerët."^[1]

Melaiket mallkojnë edhe banorët e zjarrit, pasi banorët e xhenetit t'i kenë nënçmuar ata. Allahu thotë: *"Ata të xhennetit i thërrasin (i pyesin) banuesit e zjarrit e u thonë: "Ne e gjetëm të vërtetë atë që na e pat premtuar Zoti ynë, e ju (banues të zjarrit) a e gjetët të vërtetë atë që ua pat premtuar Zoti juaj?" Ata (banuesit e zjarrit) thonë: "Po". Atëherë në mes të tyre (mes dy grupeve) thërret një zë: "Mallkimi i Allahut qoftë mbi zullumqarët!"* El-A'raf: 44

Imam Kurtubiu thotë: "... atëherë në mes të tyre (mes dy grupeve) thërret një zë...), d.m.th. thërret një zë nga melaiket."^[2] Më herët përmendëm se melaiket e mallkojnë shpirtin e jobesimtarit dhe thonë: "Shpirt i fëlliqur erdhi nga Toka."^[3]

Kanë ardhur argumente që tregojnë se melaiket luten për dënim dhe hidhërim ndaj disa njerëzve për shkak të punëve të tyre të këqija. Këtu përfshihen:

1) Lutja kundër atij që shpik ndonjë bidat në Medinë

Nga Enesi radijallahu anhu përcillet se i Dërguari sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Medina është harem (e shenjtë) nga ky vend deri në këtë vend, nuk pritet pema e saj dhe nuk shpiket në të bidat. Kush shpik në të bidat, mbi të qoftë mallkimi i Allahut, i melaikeve dhe i tërë njerëzimit!"*^[4]

Muslimi transmeton nga Ebu Hurejra radijallahu anhu, e ai nga i Dërguari sal-lallahu alejhi ve sel-lem, se ka thënë: *"Medina është harem. Kush shpik në të bidat apo i bën vend ndonjë bidati, mbi të qoftë mallkimi i Allahut,*

i melaikeve dhe i tërë njerëzimit. Ditën e Gjykimit nuk do të pranohet nga ai adlun^[5]*dhe as sarfun."*^[6]

Ibën el-Ethiri thotë: "El-hadeth është çështja e panjohur, e cila nuk është e njohur në Sunnet, ndërsa muhdith ka për qëllim atë që ndihmon vrasësin, zullumqarin, e strehon atë ose e merr nën përkudese për ta mbrojtur nga kundërshtari i tij dhe pengon që të mos dënohet. Ndërsa muhdeth është vetë çështja e shpikur. Kuptimi i fjalës ijvaun, strehim, ka për qëllim kënaqjen me bidatin dhe durimin që ajo të zërë vend sepse ai që është i kënaqur me bidatet apo pajtohet me vepruesin e tij dhe nuk e kundërshton atë, vetëm se e ka strehuar dhe i ka bërë vend bidatit. Në hadith thuhet: *"Kini kujdes nga gjërat e shpikura."* Muhdethat është shumësi i fjalës muhdethetun me zanoren e, që d.m.th. gjëra që nuk janë të njohura në Kur'an, Sunnet apo konsensus."^[7]

Shpikja për të cilën melaiket e mallkojnë vepruesin dhe ndihmuesin e saj është shpikja në fe. Allahu e di më së miri. Pasi Medina ishte vendnisja e Islamit, vendstrehimi i zemrave të besimtarëve dhe vendqëndrimi i besimit, veprat në të u bënë si të ishin sunnet sepse ata që shihnin atë që bënin banorët e Medinës, mendonin se ishte sunnet nga i Dërguari sal-lallahu alejhi ve sel-lem dhe prandaj shpikja e bidateve në të është më e rëndë sesa jashtë saj, edhe pse bidatet që të gjitha janë humbje dhe devijim, siç vërtetohet nga i Dërguari sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i cili ka thënë: *"Kush shpik një bidat apo e strehon dhe e mbron atë, mallkimi i Allahut, i melaikeve dhe i tërë njerëzimit qoftë mbi të!"*^[8] Mirëpo bidati në Medinë është më i rëndë dhe më i keq, kurse vepruesi i tij i

[1] Tefsir Kurtubi (9\18).

[2] Po aty (7\209).

[3] Muslimi (2782).

[4] Buhariu (1768), Muslimi (1366).

[5] El-Adlu domethënë adhurim, por thuhet se qëllimi janë adhurimet farze, obligative, ndërsa sarfun ka kuptimin nuk i pranohet pendimi, por thuhet se qëllimi është adhurimi nafile, vullnetar. Shiko En-Nihaje të Ibën El-Ethir (3\190).

[6] Muslimi (1371).

[7] En-Nihaje (1\351).

[8] Imam Ahmedi në Musned (1\119) nga Aliu radijallahu anhu, zinxhiri i tij është sahih, shiko Musnedin me verifikim të Ahmed Shakirit (2\958).

është ekspozuar një kërcënim i rreptë, që u përmend në hadithin e kaluar. Pra, muslimani le të ketë kujdes që të mos e kaplojë ky dënim i rëndë dhe le të kujdeset për Sunnetin e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, sidomos banorët e Medinës.

2) Mallkimi i melaikeve ndaj atyre që mallkojnë shokët e Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem

Allahu i Madhërishëm në Kur'an i ka lavdëruar shokët e të Dërguarit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem dhe i ka cilësuar si të drejtë, duke i cilësuar gjithashtu me cilësi që nuk janë përmendur për të tjerë pas Pejgamberëve. Ky lavdërim nuk është bërë për gjë tjetër pos për pozitën e lartë që kanë tek Allahu. Allahu gjithashtu na ka lajmëruar se Ai është i kënaqur me ta dhe se ata janë të kënaqur me Të dhe ka qartësuar se Allahu i ka përmendur sahabët edhe tek ithtarët e Tevratit dhe Inxhilit. Allahu thotë:

"Muhamedi është i Dërguar i Allahut, e ata që janë me të (sahabët) janë të ashpër kundër jobesimtarëve, janë të mëshirshëm ndërmjet vete, ti i sheh tek përulën (në ruku), duke rënë me fytyrë në tokë (në sexhde) e kërkojnë prej Allahut që të ketë mëshirë dhe kënaqësinë e Tij ndaj tyre. Në fytyrat e tyre shihen shenjat e gjurmës së sexhdes. Përshkrimi i cilësive të tyre është në Tevrat dhe po ky përshkrim është edhe në Inxhil. Ata janë si një farë e mbjellë, ku filizi i vet mbin e trashet, përforcohet dhe qëndron në trungun e vet e ajo e mahnit mbjellësin. Allahu i shumoi për t'ua shtuar me ta millefën jobesimtarëve. Allahu atyre që besuan dhe bënë vepra të mira u premtoi falje të mëkateve dhe shpërblim të madh." El-Fet'h: 29

Allahu gjithashtu thotë: *"Allahu është i kënaqur me të hershmit e parë prej muhaxhirëve (migruesve) dhe prej ensarëve (vendasve ndihmëtarë) dhe prej atyre që i pasuan ata me punë*

të mira, e edhe ata janë të kënaqur ndaj Tij. Atyre u ka përgatitur xhennete, në të cilët rrjedhin lumenj, ku do të jenë përjetë të pasosur. E ky është fitim i madh." Et-Tevbe: 100

Ajetet që flasin për këtë tematikë janë të shumta. Edhe Sunneti është i mbushur me lavdërimin dhe cilësimin e tyre me të mira dhe qartësimin se dashuria ndaj tyre është iman (besim), ndërsa urrejtja e tyre është nifak (dyfytërsi). Kemi argumente të shumta që e bëjnë haram (të ndaluar) rreptësisht fyerjen apo të folurit keq për ta. Nga këto thënie është hadithi që përcjell Imran ibën Husajni radijallahu anhum, i cili thotë: "I Dërguari sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Njerëzit më të mirë janë ata të shekullit tim, pastaj ata që vijnë pas tyre, pastaj ata që vijnë pas tyre."* Imrani thotë: - Nuk e di a i përmendi pas shekullit të tij dy shekuj apo tre, pastaj tha: *"Pastaj pas jush do të ketë njerëz që dëshmojnë, por nuk u kërkohet dëshmia, tradhtojnë dhe nuk janë të besueshëm, zotohen dhe nuk e zbatojnë zotimin dhe shfaqet tek ata trashësia."*[9]

Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem ka përmendur se prezenca e sahabëve është garanci për ummetin e tij në përgjithësi, siç tregohet në hadithin e Ebu Burdes nga babai i tij. "E kemi falur namazin e akshamit me të Dërguarin e pastaj thamë që sikur të ulemi e të presim ta falim jacinë me të. U ulëm, kur ja i Dërguari doli e na tha: *"Ende jeni këtu?"* Ne ia kthyem: -O i Dërguari i Allahut, e falëm me ty akshamin e pastaj thamë të ulemi e ta falim edhe jacinë me ty. I Dërguari tha: *"Mirë keni vepruar"* ose tha: *"Ja keni qëlluar."* Pastaj e ngriti kokën nga qielli dhe shpesh vepronte ashtu e atëherë tha: *"Yjet janë garanci për qiellin. Nëse largohen ato, atëherë qiellit i vjen ajo që i është premtuar, ndërsa unë jam garanci për shokët e mi. Kur të shkoj unë, u vjen shokëve të mi ajo që u është premtuar,*

[9] Buhariu (3449), Muslimi (2535).

ndërsa shokët e mi janë garanci për ummetin tim. Kur ata shkojnë, ummetit tim i vjen ajo që i është premtuar."^[10]

I Dërguari ka tërhequr vërejtjen nga fyerja dhe nënçmimi i tyre duke thënë: *"Mos i shani shokët e mi, mos i shani shokët e mi, se pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, edhe nëse dikush nga ju shpenzon ar sa kodra e Uhudit, nuk do ta arrijë vlerën e dy grushtave të tyre e as sa gjysma e tyre!"*^[11]

Melaiket i duan dhe ata e duan Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe janë armiq të atij që armiqësohet me Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Melaiket i duan shokët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe armiqësojnë dhe urrejnë ata që i shajnë dhe armiqësojnë sahabët. Ajo që tregon për këtë është hadithi të cilin e përcjell Ebu Hurejra radijallahu anhu. "I Dërguari ka thënë: *"Allahu kur e do një rob, e thërret Xhibrilin dhe i thotë: "Unë e dua filanin duaje edhe ti." Xhibrili e do atë, pastaj Xhibrili thërret tek banorët e qiejve: "Allahu e do filanin, duajeni edhe ju!" E atëherë e duan banorët e qiellit. Pastaj bëhet i pranueshëm tek njerëzit në tokë. E, nëse Allahu e urren një person, e thërret Xhibrilin dhe i thotë: "Unë e urrej filanin, urreje edhe ti!" Xhibrili e urren atë, pastaj thërret te banorët e qiellit dhe thotë: "Allahu e urren filanin, urrejeni edhe ju!" Edhe ata e urrejnë, pastaj vendoset urrejtja për të tek njerëzit në tokë.*"^[12]

Nuk ka dyshim se atë që i do sahabët radijallahu anhum, do ta kaplojë vlera e këtij hadithi dhe se atë që i urren ata do ta kaplojë urrejtja e Allahut, e melaikeve dhe e banorëve të tokës. Realiteti e tregon një gjë të tillë, ve la havle ve la kuv-vete il-la bil-lah!

Në disa hadithe është shumë i qartë mallkimi i melaikeve për ata që fyejnë shokët e Muhamedit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, siç qëndron në hadithin e Abdullah ibën Abasit radijallahu anhuma. "I Dërguari ka thënë: *"Kush i shan shokët e mi, mallkimi i Allahut, i melaikeve dhe i tërë njerëzimit qoftë mbi të!"*^[13]

Medito rreth dënimit të atij që i shan sahabët që ta dish fëlliqësinë e kësaj çështjeje të rëndë, e cila mund të ndodhë vetëm nga ai të cilit Allahu ia ka fshirë të parët e zemrës. Medito rreth fjalës së Ebu Zur'as për ata që shajnë shokët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem në mënyrë që ta dish esencën e këtij drejtimi dhe shkakun e përhapjes së tij. Ai thotë: "Nëse sheh dikë duke folur keq për ndonjërin nga sahabët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, dije se ai është zindik (i dalë prej feje), ngase Pejgamberi është i vërtetë dhe Kur'ani është i vërtetë dhe nuk ka dyshim se Kur'anin dhe Sunnetin e kanë përcjellë tek ne shokët e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Dëshirojnë t'i akuzojnë dëshmitarët tanë (sahabët) në mënyrë që ta shpallin si të kotë Kur'anin dhe Sunnetin, por ata janë vetë të akuzuar dhe janë të dalë prej feje."^[14]

3) Mallkimi i melaikeve ndaj atij personi që u drejtohet muslimanit me armë

Nga Ebu Hurejra përcillet të ketë thënë: "I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Ai që i drejtohet vëllait të vet me hekur, melaiket do ta mallkojnë atë edhe nëse është vëlla i tij për nga babai e nëna.*"^[15] Shkaku i këtij mallkimi është rreziku i këtij

[10] Muslimi (2531). Imam Nevevi kur sqaron këtë hadith thotë: "Kuptimi i hadithit është se përdërisa yjet janë dhe ekzistojnë, edhe qielli ekziston dhe qëndron, por kur yjet bien dhe shkapërderdhën, atëherë qielli rraskapitet, çahet dhe pëlcet e kështu shkatërrohet. Fjala e të Dërguarit: "Unë jam garanci për shokët e mi, kur unë të shkoj, shokëve të mi u vjen ajo që u është premtuar" ka kuptimin e sprovave, luftërave, dezertimit të arabëve nga feja, thyerja e zemrave. E tërë kjo ka ndodhur. Pjesa e tretë e hadithit: "Shokët e mi janë garanci për ummetin tim, kur të shkojnë ata, ummetit tim i vjen ajo që i është premtuar", ka kuptimin e shfaqjes së bidateve në fe dhe sprovave të shumta, triumfit të romakëve ndaj tyre, përcimit të Medinës dhe Mekës etj.. Të gjitha këto ishin nga mrekullitë e të Dërguarit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. El-Minhaxh, sqarim i Sahihut të Muslimit (15/299) (sh.p.).

[11] Buhariu (3/1343, nr 3273), Muslimi (2540).

[12] Buhariu (3/1175, nr 3037), Muslimi (4/2030, nr 2637) dhe shprehja është e tij (Muslimit).

[13] Taberaniu (12/142, nr. 12709) zinxhiri i tij është i mirë, shiko Sahihul Xhami' (nr. 6161) dhe Es-silsile es-sahiha (nr. 2340).

[14] El-Kifaje, autor Hatib el Bagdadij (fq. 97).

[15] Muslimi (4/2020, nr. 2161).

veprimi dhe frika se mos e godet dhe e vret, duke merituar dënimin e vrasësit. Sa dënim i rëndë është ai, Allahu e di më së miri! Kjo është sqaruar në një hadith tjetër, që e përcjell Ebu Hurejra radijallahu anhu nga i Dërguari: *"Mos t'ia drejtojë ndonjëri nga ju armën vëllait të vet sepse ai nuk e di, ndoshta shejtani e ngacmon në dorën e tij dhe kështu bie në gropë të xhehennemit."*^[16]

4) Mallkimi i melaikëve ndaj atij që pengon të mos zbatohet kisasi, ekzekutimi ndaj atyre që e meritojnë dhe për atë që ndalon nxjerrjen e shpagimit (për familjarët e viktimës)
Nga mëshira e Allahut për njerëzit është edhe bërja e ligjshme e zbatimit të ndëshkimeve, që mbrojnë jetën, nderin dhe pasurinë e tyre. Kush i ndalon këto është njeri i humbur që meriton mallkimin dhe dënimin e Allahut, të melaikëve dhe të të gjithë njerëzve në përgjithësi, siç ka ardhur në hadithin e Abdullah ibën Abasit. "I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Kush e vret dikë gabimisht... me gur, kamxhik apo shkop, ka obligim të paguajë dëmin e gabimit, ndërsa ai që e vret dikë me qëllim, vritet. Ai që ndërmetjetëson mes të vrarit dhe zbatimit të këtij ligji për të qoftë mallkimi i Allahut, i melaikëve dhe i gjithë njerëzimit. Allahu nuk pranon prej tij sarfen dhe as adlen."*^[17]

5) Mallkimi i melaikëve për gruan që refuzon burrin e saj

Nga Ebu Hurejra përcillet të ketë thënë: "I Dërguari ka thënë: *"Nëse njeriu e thërret gruan e tij në shtrat dhe ajo refuzon të shkojë, melaiket do ta mallkojnë deri në mëngjes."*^[18]

6) Lënia e lutjeve nga ana e melaikëve për gratë që vajtojnë

Më parë kemi përmendur se melaiket luten

për ne dhe se lutja ka gjurmët e veta për daljen nga errësira në dritë, por janë disa vepra të këqija për të cilat vepruesi i tyre dënohet duke u privuar nga lutja e melaikëve për të. Nga këto vepra është edhe vajtimi ndaj të vdekurit, siç përcillet nga Ebu Hurejra radijallahu anhu, se i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Melaiket nuk luten për vajtoren dhe as për atë që bërtet për të vdekurin."*^[19]

Nuk ka dyshim se vajtimi është nga veprat e këqija për të cilat i Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka tërhequr vërejtjen dhe ka qartësuar se është nga veprat e injoracës. Ai është distancuar nga personi që vepron një gjë të tillë.^[20]

Es-Sindij thotë: "Fjala e tij (në hadith): *"Melaiket nuk luten"*, do të thotë siç luten për besimtarët e tjerë. Allahu thotë: *"Ai ju mëshiron ju, edhe engjëjt e Tij luten. Në të ka argument se Allahu nuk e mëshiron vajtoren, por mund të thuhet gjithashtu se veçimi i melaikëve në hadith, se nuk luten për vajtoren, do të thotë se mëshira e Allahut nuk ndalet, por vetëm lutja e melaikëve, sepse mëshira e Allahut ndalet vetëm për jobesimtarët, ndërsa lutja e melaikëve dhe mëshira e tyre për ta është vlerë shtesë, prandaj ndërprerja e saj nuk i dëmton mëkatarët. Allahu e di më së miri."*^[21]

Në fund, themi se është obligim për besimtarin që të ketë kujdes nga këto vepra të rrezikshme, në mënyrë që të mos e meritojë këtë dënim të madh, mallkimin e melaikëve. Kërkojmë mbrojtjen e Allahut nga kjo.

Dr. Muhamed ibën Abdulvehab EL AKIL

"Bindjet e fraksioneve muslimane dhe feve të tjera rreth melaikëve të ndersbëm"

Përshtati: Mr. Fidan XHELILI

Aman / Jordani

[16] Po aty (nr. 2617).

[17] Nesaiu (8/40), Ebu Davudi (4/196, nr. 4591), Ibën Maxheh (2/880, nr. 2635), zinxhiri i tij është sahih, shiko Sahihul Xhami' (5/336, nr. 6326).

[18] Buhariu (5/1994, nr. 4897).

[19] Transmeton Ebu Dvud Et-Tajalisi. Shiko El-minha (1/157), imam Ahmedi në Musned (2/362), zinxhiri i tij është i mirë.

[20] Shiko Et-tergib vet-terhib (4/348), babu et-terhib min en-nijahati.

[21] Shiko Musnedin e imam Ahmedit me verifikim të dijetar Shuajb Arnautit (14/358).



GJYKIMI PËR KËRKIMIN E NDIHMËS NGA XHINËT DHE SHEJTANËT

DHE ZOTIMIT NDAJ TYRE -II-

"Çdo Pejgamber ka një lutje të pranuar. Secili prej tyre e ka përshpejtuar atë (pra e ka bërë sh.p.), ndërsa unë e kam ruajtur lutjen time për të ndërmjetësuar për ummetin (popullin) tim Ditën e Gjykimit. Ajo përfshin, në dashtë Allahu, të gjithë ata që kanë vdekur prej ummetit tim e që nuk i kanë shoqëruar Allahut shok."

Gjithashtu është transmetuar në lidhje me këtë çështje fjala e Allahut të Madhëruar: *"Adhuro pra Allahun (Një e të Vetëm) duke plotësuar detyrat e fesë së Tij me çiltërsi e përkushtim vetëm për hir të Tij. Medoemos se feja e vërtetë (adhurimi, përkushtimi e nënshtrimi) është vetëm për Allahun. Dhe ata që zgjedhin për mbrojtës e ndihmues të tjerë në vend të Tij (thonë): "Ne i adhurojmë ata vetëm që ata të mund të na afrojnë tek Allahu." Pa dyshim që Allahu do të gjykojë mes tyre në lidhje me atë për çfarë ata ndryshuan. Sigurisht që Allahu nuk e udhëzon atë që është gënjeshtar, mohues."* Ez-Zumer: 2-3

Dhe: *"Dhe adhurojnë në vend të Allahut gjëra që as i dëmtojnë dhe as nuk u sjellin dobi dhe thonë: "Këta janë ndërmjetësuesit tanë tek Allahu." Thuaju: "A mos e njoftoni Allahun për çfarë Ai nuk di se çfarë ka në qiej dhe në tokë?"*

Lavdi i qoftë dhe i lartë është Ai përmbi gjithçka që ata ia mveshin dhe ia bashkojnë Atij si shokë e të barabartë (me Të)!" Junus: 18
Allahu i Madhëruar na tregon në këto dy ajete se mushrikët (ata që i shoqërojnë shok Atij) adhuruan krahas Tij njerëz të mirë, duke iu lutur atyre, duke i pasur frikë, duke shpresuar tek ata, duke u bërë kurbane atyre, duke bërë zotime për ta dhe punë të tjera si këto. I vepronin këto punë duke pretenduar se ata njerëz të mirë i afronin ata që i adhuronin (ata njerëz të mirë) tek Allahu dhe bënë ndërmjetësim për ta tek Ai. Allahu i Madhëruar i përgënjeshtroi ata dhe sqaroi të kotën e tyre. Ai i quajti ata gënjeshtarë, mosbesimtarë dhe mushrikunë. Ai e pastroi Veten e Tij nga shirku i tyre (shoqërimi shok në adhurimin e Tij). Allahu i Madhëruar thotë: *"Lavdi i qoftë dhe i lartë është Ai*

përmbi gjithçka që ata ia mveshin dhe ia bashkojnë Atij si shokë e të barabartë (me Të)!"

Junus: 18

Atëherë mësohet se ai që i lutet dhe i kërkon ndihmë ndonjë engjëlli, Pejgamberi, xhini, peme apo ndonjë guri, u zotohet atyre dhe u bën kurban duke shpresuar që ata të ndërmjetësojnë tek Allahu për të apo ta afrojnë atë tek Ai, apo shpreson që ata të shërojnë të sëmurin apo të ruajnë pasurinë, apo shpreson nga ata shëndetin e atij që nuk është prezent dhe gjëra të tjera të kësaj natyre, mësohet se ai ka rënë në këtë shirk të madh dhe fatkeqësi të rrezikshme për të cilën Allahu ka thënë: ***"Pa dyshim se Allahu nuk fal t'i vihet Atij shok në adhurim, por Ai fal përveç kësaj. Dhe kushdo që i vë shok Allahut në adhurim, vërtet ai ka shpifur një gjynah të tmerrshëm."***

En-Nisa: 48

Gjithashtu, ka thënë: ***"Nuk ka dyshim se kushdo që i vë shok në adhurim Allahut, atëherë Allahu e ka bërë haram (të ndaluar) xhennetin për të dhe vendbanimi i tij do të jetë zjarri. Dhe për dhalimunët (mosbesimtarët, keqbërësit e mizorët) nuk do të ketë asnjë ndihmues."*** El-Maideh: 72

Ndërmjetësimi realizohet Ditën e Gjykimit për ata që e njësuan Allahun në adhurim dhe ishin të sinqertë ndaj Tij dhe jo për ata që i shoqërojnë shok Ati, ashtu siç ka thënë Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, kur u pyet: "O i Dërguari i Allahut, kush është njeriu më i gëzuar me ndërmjetësimin tënd (Ditën e Gjykimit)?"

Ai tha: ***"Ai që thotë "La ilahe il-lAllah" (nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut) me sinqeritet nga zemra e tij apo vetja e tij."*** Transmeton Buhariu, nr. 99 Gjithashtu ka thënë:

"Çdo Pejgamber ka një lutje të pranuar. Secili prej tyre e ka përshpejtuar atë (pra e ka bërë sh.p.), ndërsa unë e kam ruajtur lutjen time

për të ndërmjetësuar për ummetin (popullin) tim Ditën e Gjykimit. Ajo përfshin, në dashtë Allahu, të gjithë ata që kanë vdekur prej ummetit tim e që nuk i kanë shoqëruar Allahut shok."^[1]

Mushrikët e parë besonin se Allahu është Zoti i tyre, krijuesi i tyre dhe furnizuesi i tyre, porse ata u lidhën pas Pejgamberëve, njerëzve të mirë, pemëve, gurëve dhe të tjera si këto. Ata shpresonin ndërmjetësimin e tyre për ata tek Allahu dhe afrimin tek Ai nëpërmjet atyre, ashtu siç u tha në ajete. Allahu nuk i justifikoi ata me pretendimin e tyre, as i Dërguari i Tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Përkundrazi, Allahu i kundërshtoi ata në Librin e Tij të Madhëruar (Kur'anin), i quajti mosbesimtarë dhe mushrikë dhe i përgënjeshtroi në pretendimin e tyre se këta zota ndërmjetësojnë për ta dhe i afrojnë tek Allahu. Gjithashtu, i Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem të, i luftoi ata për shkak të këtij shirku derisa t'ia dedikonin adhurimin vetëm Allahut, duke vënë në veprim fjalën e Allahut të Madhëruar:

"Dhe luftoji ata derisa të mos ketë më fitneh (mosbesim, politeizëm) dhe feja e adhurimi të jetë plotësisht vetëm për Allahun." El-Enfal: 39 I Dërguari i Allahut, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Jam urdhëruar që t'i luftoj njerëzit derisa të dëshmojnë se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, të falin namazin dhe të japin zekatin. Nëse e veprojnë këtë, kanë siguruar nga unë gjakrat dhe pasuritë e tyre, përveçse me të drejtën e Islamit (e ka fjalën për sanksionet e Islamit sh.p.), ndërsa llogaria e tyre është tek Allahu."^[2] Kuptimi është derisa të veçojnë Allahun në adhurim pa i shoqëruar Atij shok. Mushrikët kishin frikë nga xhinët dhe kërkonin mbrojtje prej tyre dhe Allahu zbriti rreth kësaj çështjeje fjalën e Tij:

[1] Hadithin e ka saktësuar Albani në Sahihul-Xhamië, nr. 5176

[2] Transmeton Buhariu dhe Muslimi

"Dhe vërtet që pati burra nga njerëzit të cilët iu mbështetën burrave nga radhët e xhinëve, por ata (xhinët) ua shtuan atyre (njerëzve) mëkatet dhe mosbesimin." Xhin: 6

Dijetarët e tefsirit (shkenca e komentimit të Kur'anit) rreth ajetit të nderuar kanë thënë: "Kuptimi i fjalës se Tij: "Por ata (xhinët) ua shtuan atyre (njerëzve) mëkatet dhe mosbesimin" është se ua shtuan frikën sepse xhinët madhëronin veten e tyre dhe kishin mendjemadhësi kur shikonin që njerëzit kërkonin mbrojtje prej tyre dhe në këtë rast ua shtonin frikën në mënyrë që njerëzit të shtonin adhurimin ndaj tyre dhe mbështetjen tek ata. Allahu ua zëvendësoi muslimanëve këtë gjë me kërkimin e mbrojtjes nga Ai dhe me Fjalët e Tij të plota. Ai zbriti rreth kësaj çështjeje Fjalën e Tij:

"Edhe nëse të vjen ndonjë pëshpëritje e ligë prej shejtanit, atëherë kërko mbrojtje e mbështetje tek Allahu. Vërtet Ai është Gjithëdëgjues, i Gjithëditur." El-A'raf: 200

Dhe: **"Thuaj: "I mbështetem (Allahut) Zotit të agimit (të më ruajë)."** El-Felek: 1

"Thuaj: "I mbështetem (Allahut) Zotit të njerëzve." En-Nas: 1

Transmetohet në rrugë të saktë se Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: *"Kush ndalet në një vend dhe thotë kërkoj mbrojtje me fjalët e përsosura të Allahut nga e keqja që ka krijuar, nuk e dëmton atë asgjë derisa të largohet prej aty."*^[3]

Ai që kërkon shpëtimin, mbrojtjen e fesë së tij dhe ruajtjen nga shirku, i vogël apo i madh qoftë, mëson duke u bazuar në ajetet dhe hadithet më lart se lidhja me të vdekurit, engjëjt, xhinët dhe krijesat e tjera; lutja ndaj tyre dhe kërkitimi i mbrojtjes nga ata dhe vepra të ngjashme me to janë prej punëve të injorantëve, mushrikëve dhe prej shirkut (shoqërimit shok Allahut) më të urryer. Është e obligueshme lënia e këtij shir-

ku, paralajmërimi ndaj tij, këshillimi me njëri-tjetrin për lënien e tij dhe qortimi i atij që e vepron atë.

Nuk lejohet martesë me ata që njihen për këto vepra shirku, as ngrënia e mishit që ata e therrin, as namazi për ta (t'u falësh xhenazen sh.p.), as namazi pas tyre (të jenë imamë në namaz) derisa të shfaqin pendimin e tyre tek Allahu i Madhëruar nga këto vepra dhe ta veçojnë Atë në lutje dhe adhurim.

Lutja është vetë adhurimi, bile esenca e tij, ashtu siç ka thënë Pejgamberi sal-lallahu alejhi ve sel-lem:

"Lutja është vetë adhurimi."^[4] Dhe në një shprehje tjetër: **"Lutja është esenca e adhurimit."**^[5] Allahu i Madhëruar ka thënë:

"Dhe mos u martoni me mushriket (femra idhujtare, mohuese), derisa ato të besojnë (të adhurojnë vetëm Allahun). Dhe nuk ka dyshim se një robëreshë besimtare është më e mirë se një mushrike (idhujtare e lirë), edhe pse ajo mund t'ju mahnitë ju. Dhe mos ua jepni (bijat tua) për martesë mushrikëve (idhujtarëve), derisa ata të besojnë (e të adhurojnë vetëm Allahun). E nuk ka dyshim se një rob besimtar është më i mirë se një mushrik (idhujtari i lirë), edhe pse ai mund t'ju mahnitë ju. Ata (mushrikët) ju ftojnë ju në zjarr, e Allahu ju fton në xhennet dhe falje me Vullnetin e Vet dhe i bën të qarta ajetet (provat, treguesit, shpalljet) e Tij për njerëzimin, që ata të mund të përkujtojnë." El-Bekareh: 221

Allahu i Madhëruar i ka ndaluar muslimanët që të martohen me mushriket, siç janë ato që adhurojnë idhujt, xhinët, engjëjt etj., derisa të besojnë në veçimin e Allahut në adhurim, të besojnë të Dërguarin, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, në ato gjëra me të cilat ka ardhur dhe të ndjekin rrugën e tij.

Gjithashtu, Ai ka ndaluar martesën e mushrikëve me muslimanet derisa të besojnë në

[3] Hadithin e ka saktësuar Albani në Sahihul-Xhamië, nr. 6567

[4] Hadithin e ka saktësuar Albani në Sahihul-Xhamië, nr. 3407

[5] Hadithin e ka dobësuar Albani në Daifull-Xhamië, nr. 3003

veçimin e Allahut në adhurim, të besojnë të Dërguarin dhe ta ndjekin atë. Allahu i Madhëruar na ka lajmëruar se robëresha besimtare është më e mirë se ajo që i shoqëron shok Allahut dhe është e lirë (nuk është robëreshë). Kjo edhe në qoftë se e habit shikuesin dhe dëgjuesin me bukurinë e saj dhe fjalën e bukur të saj. Gjithashtu na ka lajmëruar se robi besimtar është më i mirë se ai që i shoqëron shok Allahut e është i lirë (nuk është rob), edhe në qoftë se e habit dëgjuesin dhe shikuesin me bukurinë, oratorinë, trimërinë e tij dhe gjëra të tjera. Pastaj Allahu i Madhëruar i bëri të qartë shkaqet e kësaj përparësie me fjalën e Tij:

"Ata (mushrikët) ju ftojnë ju në zjarr. "Ka për qëllim me këtë mushrikët dhe mushriket, sepse ata janë thirrës për në zjarr me fjalët e tyre, me veprat e tyre, me rrugën e jetës së tyre dhe moralin e tyre. Ndërsa besimtarët dhe besimtare janë prej thirrësve për në xhemnet me moralin e tyre, me veprat e tyre dhe me rrugën e jetës së tyre. Si mund të barazohen ata me këta?"

Allahu i Madhëruar thotë për munafikët (ata që shfaqin Islamin dhe fshehin mosbesimin): "Dhe asnjërit prej tyre, kur të vdesin, mos ia fal namazin (xhenazen) kurrë, e as mos qëndro pranë varrit të tij. Me të vërtetë që ata nuk besuan Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe vdiqën duke qenë fasikunë (të pabindur e të panënshtruar ndaj Allahut dhe ndaj të Dërguarit të Tij, Muhamedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem.)." Et-Tevbeh: 84

Allahu i Madhëruar ka qartësuar në këtë ajet të nderuar që nuk i falet xhenazja munafikut dhe mosbesimtarit si rezultat i mohimit të Allahut dhe të të Dërguarit të Tij, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Gjithashtu nuk lejohet të falemi pas tyre (të jenë imamë në namaz) dhe nuk lejohet të jenë prijës të muslimanëve si pasojë e mohimit të tyre, mospasjes siguri nga ta, armiqësisë së madhe mes tyre dhe muslimanëve dhe mosqenies së tyre

prej atyre që falen dhe adhurojnë Allahun. Kufri (mohimi) dhe shirku (shoqërimi shok Allahut) i zhvlerësojnë veprat, Allahu na ruajtë nga kjo gjë!

Allahu i Madhëruar ka thënë rreth ndalimit të ngrënies së ngordhësirës dhe kurbanit të mushrikëve:

"Mos hani (o besimtarë) nga ai (mish) mbi të cilin nuk është përmendur Emri i Allahut (kur është therrur kafsha), sepse sigurisht që është fisk (gjynah dhe mosbindje ndaj Allahut). Dhe vërtet që shejtanët i frymëzojnë miqtë e tyre nga mesi i njerëzve që t'ju kundërshtojnë ju dhe po t'u bindeni atyre (duke i bërë gjërat e paligjshme të ligjshme), atëherë pa dyshim që do të ishit mushrikë (mosbesimtarë, që besojnë në shumë zota)." El-Ena'm: 121

Allahu i Madhëruar i ka ndaluar muslimanët nga ngrënia e ngordhësirës dhe kurbanit të mushrikut sepse është nexhis (e papastër). Kurban i mushrikut ka gjykimin e ngordhësirës edhe në qoftë se përmend emrin e Allahut sepse përmendja e Allahut nga ai është e kotë dhe nuk ka vlerë, pasi kurban i është adhurim. Shirku e zhvlerëson adhurin dhe e hedh poshtë atë derisa mushriku të pendohet tek Allahu. Allahu na ka lejuar që të hamë nga ushqimi (ku futet edhe kurban i sh.p.) i ithtarëve të librit (çifutëve dhe të krishterëve) në Fjalën e Tij:

"Ushqimi (mishi i bagëtive të therura, i kafshëve të tjera të ngrënshme etj.) i ithtarëve të Librave të Parë (jehudive dhe të krishterëve) është i ligjshëm për ju dhe i juaji është i lejuar për ta." El-Maideh: 5

Kjo sepse ata i përkasin një feje qiellore dhe pretendojnë se janë pasuesit e Musait dhe Isait, edhe pse gënjejnë në këtë pikë. Allahu i Madhëruar e ka shfuqizuar fenë e tyre dhe e ka hedhur poshtë me dërgimin e Muhamedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem te të gjithë njerëzit. Porse Allahu i Madhëruar na e ka lejuar ushqimin e ithtarëve të librit dhe gratë e tyre (martesën me to sh.p.) si

shkak i një urtësie të madhe dhe disa të fshehtave që janë marrë në konsideratë, të cilat i kanë sqaruar njerëzit e dijes, në kundërshtim me mushrikë si adhuresit e idhujve dhe Pejgamberëve të vdekur, njerëzve të mirë që kanë vdekur dhe të tjerë veç tyre. Ndalea erdhi sepse feja e tyre nuk ka bazë, nuk ka asnjë dyshim për këtë. Ajo fe është e kotë duke u nisur nga rrënjët e saj, e si rrjedhojë kurbanit i tyre është si ngordhësira. Nuk lejohet ngrënia e kurbanit të tyre. Kurse për sa i përket fjalës së personit që ia thotë bashkëbiseduesit të tij:

"Të zënçin xhinët!" apo "Të marrshin xhinët!" apo "Të fluturofshin shejtanët (xhinët që kundërshtojnë Allahun)!" dhe shprehje të tilla si këto hyjnë në grupin e sharjeve dhe fyerjeve dhe nuk lejohen mes muslimanëve, ashtu siç nuk lejohen sharjet dhe fyerjet e tjera. Këto nuk janë shirk, vetëm nëse ai që i thotë beson se xhinët veprojnë në mesin e njerëzve pa lejen e Allahut dhe dëshirën e Tij.

Ai që ka këtë besim për xhinët apo për krijesat e tjera veç tyre është mosbesimtar si shkak i këtij besimi sepse Allahu i Madhëruar është Poseduesi i çdo gjëje dhe Fuqiploti mbi çdo gjë. Ai ka në dorë të bëjë dobi dhe dëm dhe nuk ndodh asgjë pa lejen e Tij, pa dëshirën e Tij dhe pa caktimin e Tij të mëparshëm, ashtu siç thotë Allahu i Madhëruar ku urdhëron Pejgamberin e Tij, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, që të lajmërojë njerëzit për këtë bazë madhështore: *"Thuaj (O Muhamed): "Unë nuk kam asnjë fuqi përfitimi ose dëmtimi për veten time, por vetëm si të dojë Allahu. Po të kisha dijen e gajbit (të së fshehtës), atëherë do të kisha shumëfishuar e shtuar për veten time një bollëk begatie dhe asnjë e keqe nuk do të më prekte. Unë jam vetëm një këshillues dhe përgjësues për popullin që beson."* El-A'raf: 188

Atëherë, nëse zotëria i krijesave dhe më i

miri i tyre, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, nuk ka në dorë për veten e vet as dëm e as dobi përveç asaj që ka dashur Allahu, si është puna me krijesat e tjera?! Ajetet (e Kur'anit) që vijnë me këtë kuptim janë të shumta.

Të pyesësh fallxhorët, mashtruesit (që u ngajnë magjistarëve), ata që pretendojnë se njohin të ardhmen me anën e yjeve dhe persona të tillë si këta që merren me lajmet e fshehta është vepër e ndaluar dhe nuk lejohet. Besimi i tyre është edhe më i rëndë dhe më i keq, bile është prej degëve të kufrit (mosbesimit), duke u mbështetur në fjalën e Pejgamberit, sal-Allahu alejhi ve sel-lem:

"Kush shkon te një fallxhor dhe e pyet atë, nuk i pranohet namazi për 40 ditë." {Transmeton Muslimi në Sahihun e tij – libër ku ka mbledhur një pjesë të haditheve të sakta, sh.p.}. Gjithashtu transmeton në Sahihun e tij nga Muavije ibën el-Hakem es-Selmi, Allahu qoftë i kënaqur me të, se Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, ka ndaluar nga shkuarja te parashikuesit (ata që pretendojnë se dinë të ardhmen, sh.p.).

Gjithashtu kanë nxjerrë transmetuesit e suneneve (libra ku janë mbledhur hadithe) nga Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem se ka thënë:

"Ai që shkon te parashikuesi dhe e beson atë në çfarë thotë, ka mohuar atë që i është zbritur Muhamedit." [6]

Hadithet që vijnë në këtë kuptim janë të shumta.

Muslimanët e kanë për detyrë të ruhen nga pyetja e parashikuesve, fallxhorëve, mashtruesve të tjerë dhe atyre që merren me lajmet e fshehta dhe mashtrimin (ngatërrimin) qoftë nën emrin e mjekësisë apo të diçkaje tjetër. Kjo vjen si pasojë e ndalesës së sipërpërmendur nga Pejgamberi, sal-Allahu alejhi ve sel-lem, dhe paralajmërimi i tij. Hyjnë në këtë temë edhe pretendimet e disa njerëzve që nën emrin e mjekësisë futen në

[6] Hadithin e ka saktësuar Albani në Es-sahihah, nr. 2289

çështjet e fshehta. Kur nuhat ky mashtrues çallmën e të sëmurit apo shaminë e kokës së të sëmures apo gjëra të tilla dhe thotë: "Ky i sëmure apo kjo e sëmure ka bërë këtë gjë e këtë gjë", pra gjëra të fshehta që nuk i tregon nuhatja e çallmës së të sëmurit apo diçka e ngjashme me të, qëllimi është mashtrimi i njerëzve të thjeshtë në mënyrë që të thonë se ai e njeh mirë mjekësinë, llojet e sëmundjeve dhe shkaqet e tyre. Gjithashtu ekziston mundësia që t'u japë atyre (njerëzve të thjeshtë) ndonjë ilaç dhe ndodh rastësisht shërimi me caktimin e Allahut, kurse ata besojnë se shërimi erdhi si rrjedhojë e ilaçeve të tij, ndërkohë që sëmundja mund të ketë ardhur si pasojë e disa xhinëve dhe shejtanëve që i shërbejnë atij që pretendon se është mjek dhe e njoftojnë atë për disa çështje të fshehta. Mashtruesi mbështetet te këto të dhëna dhe i kënaq xhinët dhe shejtanët me adhurimin që u përshtatet atyre. Atëherë ata largohen nga i sëmuri dhe nuk e lëndojnë më. Kjo gjë është e njohur për xhinët dhe shejtanët dhe ata që u shërbejnë shejtanëve. Muslimanët e kanë për detyrë të ruhen nga këto vepra, të këshillohen me njëri-tjetrin për largimin prej tyre dhe të mbështeten tek Allahu i Madhëruar. Ata e kanë për detyrë të mbështeten tek Ai në të gjitha çështjet. Nuk ka ndonjë problem përdorimi i rukjes sheriatike (lexime të disa pjesëve nga Kur'ani dhe të disa lutjeve duke pasur si qëllim shërimin e të sëmurit në përputhje me legjislacionin islam sh.p.) dhe i ilaçeve të lejuara. Gjithashtu nuk ka problem të mjekohesh te doktorët që përdorin analiza për të sëmurin dhe të sigurohesh për sëmundjen (që je i sëmure sh.p.) me anë të mjeteve të perceptueshme. Transmetohet në rrugë të saktë nga Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, se ka thënë: *"Allahu ka zbritur për çdo së-*

mundje ilaçin e saj. E mori vesh kush e mori dhe nuk e diti ai që nuk e diti."^[7] Gjithashtu ka thënë: *"Çdo sëmundje ka ilaçin e saj. Nëse gjendet ilaçi i saj, shërohet (sëmundja) me lejen e Allahut të Madhëruar.*"^[8] Dhe: *"Mjekohuni! Dhe mos u mjekoni me haram (gjërat e ndaluara).*"^[9] Hadithet që vijjnë me këtë kuptim janë të shumta. Lusim Allahun e Madhëruar që të përmirësojë gjendjen e të gjithë muslimanëve, t'i shërojë zemrat dhe trupat e tyre nga çdo e keqe, t'i bashkojë tek udhëzimi, të na mbrojë ne dhe ata nga sprovat që të shpien në humbje dhe nga bindja ndaj shejtanit dhe miqve të tij! Me të vërtetë që Ai ka pushtet mbi çdo gjë dhe nuk ka as forcë e as fuqi pa Allahun e Lartësuar dhe të Madhëruar. Paqja, mëshira dhe begatia e Tij qofshin mbi robin dhe të Dërguarin e Tij, Muhamedin, mbi familjen dhe shokët e tij.

Abdul-Aziz ibën BAZ

*Përshtati: Ardit ULQINAKU
Rijad /Arabia Saudite*

[7] Hadithin e ka saktësuar Albani në Es-sahihah, nr. 451

[8] Hadithin e ka saktësuar Albani në Sahihul-Xhamië, nr. 5164

[9] Hadithin e ka dobësuar Albani në Daiful-Xhamië, nr. 1569



URDHËRIMI NË TË MIRË DHE NDALIMI NGA E KEQJA

“Kur në tokë shfaqen haptazi punët e liga, Allahu do të zbresë zemërimin e Tij mbi banorët e saj, edhe nëse një pjesë e tyre janë të mirë. Do t’i godasë ajo që i godet të gjithë dhe më pas kthehen te mëshira e Allahut dhe falja e Tij.”

Këto janë disa çështje besimi në të cilat ka mësim, këshilla dhe shembuj. Jemi në çështjen e tridhjetë e shtatë nga çështjet e imanit, e cila është urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja me sinqeritet të plotë.

Si pasojë e punëve të këqija të njerëzve është shfaqur në tokë dhe det shkatërrimi, ka dalë haptazi kamata dhe është shfaqur amoraliteti, tregjet janë mbushur me gra të zhveshura, po pihet alkooli, është lënë namazi dhe janë zbehur lidhjet farefisnore.

A e dini pse ka ndodhur e gjithë kjo? Sepse ummeti islam e ka lënë pas dore punën dhe detyrën e tij primare, për të cilën ka ardhur në këtë botë. Ajo është urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja.

O ummet islam! Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja është detyra dhe obligimi ynë ngase Allahu i Lartësuar thotë: *“Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin sepse ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun.”* Alu Imran: 110

Po ashtu Allahu thotë: *“Besimtarët*

dhe besimtare të janë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat.” Et-Tevbe: 71 Urdhërimi në të mirë dhe ndalimi nga e keqja është detyrë e muslimanëve të sinqertë. Nëse e lëmë pas dore këtë, do të shtohen mëkatet dhe shkatërrimi në tokë e det. E nëse shtohen mëkatet dhe punët e fëlliqura, atëherë ky ummet do të shkatërrohet. Për Allahun e Lartësuar, na është treguar se çdo ummet që është shkatërruar më parë, është shkatërruar vetëm për shkak të mëkateve. Allahu i Lartësuar thotë: *“...por për shkak të gjynaheve të veta, i shfarosëm...”* El-En’am: 6

“Ne të gjithë i dënuam për gjynahun e vet...” El-Ankebut: 41

Nga nëna e besimtarëve, Zejneb bintu Xhahshin radijAllahu anha, transmetohet se Profeti sal-lAllahu alejhi ve sel-lem një ditë hyri tek ajo i tmerruar duke thënë: *“La ilahe il-Allah! Mjerë për arabët nga e keqja që është afruar. Është hapur sot nga penda e je’xhuxhëve dhe me’xhuxhëve kaq”,* dhe bëri një rreth me gishtin e tij të madh dhe atë tregues. Unë thashë: -O i Dërguari i Allahut, a do të shkatërrohemi edhe pse në mesin tonë ka të mirë? Ai tha: *“Po, nëse shtohet e keqja.”*^[1]

Nëse shtohen mëkatet, përhapet kamata, amoraliteti, lakuriqësia dhe e keqja, do të vijë edhe dënimi nga Allahu. Allahu thotë: *“Çfarëdo fatkeqësie që ju godet, është si pasojë e asaj që keni bërë vetë; por Ai fal shumë.”* Esh-Shura: 30. Po ashtu Allahu thotë: *“...Kurse e keqja që të godet, është prej vetes sate.”* En-Nisa: 79

Dhe: *“Kur ju goditi fatkeqësia, ndërkohë ju i kishit goditur më parë armiqtë tuaj dyfish, ju thatë: “Prej nga na erdhi neve kjo?” Thuaj (o Muhamed): “Kjo ndodhi prej jush.” Vërtet, Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë.”* Alu Imran: 165

O Allah na shpëto, na shpëto! O Allah, na shpëto nga sprovat e dukshme dhe ato të padukshme!

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *“Shembulli i atij që i përfill urdhrat e Allahut dhe atij që nuk i përfill ato është si shembulli i një populli që ka zgjedhur një anije. Një pjesë e tyre janë vendosur sipër e një pjesë poshtë. Ata që ishin poshtë, kur donin të mbushnin ujë, kalonin në pjesën sipër dhe kështu thanë:*

“Sikur të hapim një vrimë në pjesën tonë poshtë, në mënyrë që mos t'i pengojmë ata që janë sipër. Nëse (ata që janë sipër) i lejojnë ta bëjnë atë që dëshirojnë, të gjithë do të vdesin, por nëse i ndalojnë, do të shpëtojnë të

[1] Transmeton Muslimi, 1987.

[2] Transmeton Buhariu.

gjithë.”^[2]

Robër të Allahut!

Mëkatarët janë shkak i shkatërrimit të një populli dhe s'ka dyshim që do të jenë të shumtë nëse ne nuk urdhërojmë në të mirë dhe ndalojmë nga e keqja. Nëse nuk veprojmë, do të zbresë dënimi dhe do të na përfshijë të gjithëve.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: *“Pasha Atë në dorën e të Cilit është shpirti im, do të urdhëroni për të mirë dhe do të ndaloni nga e keqja ose Allahu do të dërgojë mbi ju dënim e më pas do t'i luteni Atij, por nuk do t'ju përgjigjet.”*^[3]

“Kur njerëzit e shohin një të keqe dhe nuk e ndryshojnë atë, ekziston frika se do t'i përfshijë Allahu më një dënim prej Tij.”^[4]

“Kur prostitucioni dhe kamata^[5] përhapet në një popull, vetëm se e kanë lejuar dënimin e Allahut mbi veten.”^[6]

“Kur në tokë shfaqen haptazi punët e liga, Allahu do të zbresë zemërimin e Tij mbi banorët e saj, edhe nëse një pjesë e tyre janë të mirë. Do t'i godasë ajo që i godet të gjithë dhe më pas kthehen te mëshira e Allahut dhe falja e Tij.”^[7]

Nëse ne e lëmë urdhërimin në të mirë dhe ndalimin nga e keqja, do ta meritojmë mallkimin, nënçmimin dhe poshtërimin. I Dërguari sal-lAllahu alejhi ve sel-lem i ka përmendur së bashku nënçmimin, poshtërimin dhe mëkatet. Nëse nuk urdhërojmë në të mirë dhe ndalojmë nga e keqja, mëkatet do të jenë të pranishme në popull.

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *“Kur ju të punoni me kamatë, të kapeni për bishtat e lopëve (të merreni me blegtorinë), të jeni të kënaqur me bujqësinë dhe ta lini luftën në rrugën e Allahut, Allahu do ta lejojë poshtërimin tuaj dhe nuk do ta ngrejë derisa t'i ktheheni fesë suaj.”*^[8]

Poshtërimi vjen me mëkate, por a ka poshtërim më të madh se ai në të cilin gjendemi? Edhe mallkimi është për shkak të mëkateve. Allahu i Lartësuar thotë: *“Ata, beni israilët që ishin mohues, u mallkuan me gjuhën e Dautit dhe të Isait, të birit të Merjemes, për shkak se kundërshtonin, shkelnin çdo kufi dhe nuk e ndalonin njëri-tjetrin që të mos bënin vepra të këqija. Eh, sa të shëmtuara ishin*

[3] Sahih et-Tergib vet-Terhib, 2313.

[4] Sahih el-Xhami', 1984.

[5] Ku futen edhe kreditë.

[6] Sahih el-Xhami', 679.

[7] Sahih el-Xhami', 680.

[8] Sahih el-Xhami', 416.

veprat që bënëin ata!" El-Maideh: 78-79
 Ndonjëri prej nesh e sheh djalin e tij në shtëpi që nuk falet dhe nuk e këshillon atë, sheh vajzën e tij që del e zhveshur dhe nuk e kundërshton atë, sheh se si pihet alkooli dhe përhapet kamata, por fytyra e tij nuk ndryshon dhe nuk hidhërohet për hir të Allahut, nuk urdhëron në të mirë dhe nuk ndalon nga e keqja. Mëkatet na janë bërë një gjë e zakonshme. Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi.

Nëse nuk urdhërojmë në të mirë dhe ndalojmë nga e keqja, mëkatet dhe punët e liga do të shtohen, zemrat e njerëzve do të nxihen deri në atë masë sa që nuk do të njohin punë të mirë dhe nuk do t'i kundërshtojnë punët e liga. Ky është fillimi i shfaqjes së munafikëve dhe thirrësve të së keqes, të humbjes dhe sekteve, shfaqen të paditurit dhe bidatxhinjtë.

Allahu i Lartësuar thotë: ***"Hipokritët dhe hipokritet janë të ngjashëm me njëri-tjetrin (qëllimi i tyre është një), kërkojnë që të bëhen vepra të këqija e pengojnë të mirat."*** Et-Tevbe: 67

I Dërguari i Allahut sal-lAllahu alejhi ve sel-lem thotë: ***"Allahu i Lartësuar nuk e ngre diturinë duke e tërhequr atë nga robërit e Tij, por***

duke i vdekur dijetarët, derisa të mos mbetet asnjë dijetar. Atëherë njerëzit do të marrin për prijs injorantët dhe do t'i pyesin, ndërsa ata do të përgjigjen pa dituri, do ta humbin vetën dhe të tjerët."^[9]

Ummet islam!

Allahu e merr diturinë me vdekjen e dijetarëve, derisa të mos mbetet asnjë dijetar. Atëherë njerëzit do t'i marrin si udhëheqës injorantët, ashtu siç i shohim sot në mjetet e informimit. Ata i thërrasin njerëzit në fe tjetër, jo në atë që solli Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem. Ata u japin përparësi fjalëve të tyre para fjalëve të Allahut, fjalëve të Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe fjalëve të dijetarëve të gjeneratave të para. Për shkak të injorancës ndaj fesë, populli njeh vetëm këta, të cilët ua lejojnë haramin dhe ua ndalojnë hallallin. I urdhërojnë në punë të liga dhe i ndalojnë nga punët e mira, pikërisht ashtu siç veprojnë munafikët. Por, a e dini se kur shfaqen dijetarët e së keqes? Atëherë kur dijetarët e vërtetë janë të paktë.

Para një viti,^[10] ummeti musliman humbi një nga dijetarët e dalluar, hoxhën Abdul-Aziz ibën Baz, Allahu e mëshiroftë. Disa muaj më pas

[9] Sahih el-Xhami', 1850.

[10] Kjo ligjëratë është mbajtur në vitin 2000, kurse Ibën Bazi, Allahu e mëshiroftë, ka vdekur para një viti. Allahu e mëshiroftë dhe na bashkoftë me të në xhennetin Firdevs! (sh.p.)

humbi dijetarin tjetër, hadithologun e kësaj kohe, Muhamed Nasirud-Din el-Albani,^[11] Allahu e mëshiroftë. Pas një kohe të shkurtër ky ummet humbi një dijetar tjetër të dalluar, Muhamed ibën Salih el-Uthejmin, Allahu e mëshiroftë. Këto janë sprova që janë shfaqur në çdo anë: thirrës në rrugën e humbur, thirrës në grupime, thirrës në përçarje, atëherë të keni kujdes o robërit e Allahut, qëndroni në rrugën e drejtë në të cilën kanë vdekur dijetarët. Për Allahun, pa dyshim këto janë fitne, për Allahun pa dyshim se këto që po përjetojmë janë ditë të vështira të stërm bushura me gjëra që nuk i dimë. E lusim Allahun të na forcojë në iman! Kapuni fort për librin e Zotit tuaj dhe për Sunnetin e Profetit tuaj sal-lallahu alejhi ve sel-lem, për rrugën e të parëve tanë të mirë dhe të gjithë ata që ndoqën rrugën e tyre deri në Ditën e Kiametit.

Kini kujdes nga thirrësit në rrugën e humbur, nga thirrësit në përçarje, pasi me shkurt pamësinë dhe pamaturinë e tyre dëshirojnë ta hedhin këtë ummet në detin e gjakosur. Ne ju këshillojmë dhe paralajmërojmë o kërkuesit e dijes që të mos jeni me asnjërin nga këto palë, por qëndroni të paluhatshëm në rrugën e drejtë,

mos dëgjoni ata që fyejnë dijetarët! Nëse mëson te një njeri i cili të thërrret për në rrugën e Allahut, të urdhëron në të mirë dhe të ndalon nga e keqja, dëshiron që ti të jesh nga pasuesit e rrugës së drejtë duke t'i qartësuar gjërat në kuptimin e duhur dhe nuk të nxit ta përkrahësh ndonjërin prej grupeve me fanatizëm, atëherë kapu fort pas tij. Nëse sheh dikë që përgojon dijetarët dhe të fton në ndonjë grupim me fanatizëm dhe rregulla që janë bazuar në mendjet e njerëzve apo të ngjashme me këto devijime, atëherë ki kujdes.

Shiko se si udhëheqësit e injorantëve urdhërojnë në të keqe dhe ndalojnë nga e mira, e orientojnë popullin drejt përçarjeve dhe thellimit në gjakosje. Pra, kini kujdes nga thirrësit në përçarje.

Robër të Allahut!

Çdonjëri prej nesh urdhëron në të mirë dhe ndalon nga e keqja në bazë të mundësisë që ka. Profeti sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

“Kush nga ju e sheh një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e tij. E, nëse nuk mundet, atëherë le ta kundërshtojë me gjuhën e tij. E, nëse nuk mundet, le ta urrejë me zemrën e tij, e kjo është pjesa më e dobët e imanit.”^[12]

Nëse ne urdhërojmë në të mirë dhe

[11] Ky dijetar ishte nga Shkodra. Ka emigruar në Siri në moshën nëntëvjeçare me familjen e tij. Vdiq në vitin 1999 në Aman, kryeqytetin e Jordanisë. Ne e lusim Allahun që ta mëshirojë me mëshirën e Tij dhe të na bashkojë të gjithëve në xhennetin Firdevs! (sh.p.)

[12] Transmeton Muslimi.

ndalojmë nga e keqja, pa dyshim se do t'i shohim frytet e saj.

Disa prej tyre janë:

1- Allahu na ka bërë ummetin më të mirë mbi sipërfaqen e tokës. Ashtu si ka thënë Allahu i Lartësuar: *"Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin sepse urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat..."*

Alu Imran, 110

2- Allahu na ndihmon kundër armiqve tanë dhe na mundëson pushtet në tokë. Nëse urdhërojmë në të mirë dhe ndalojmë nga e keqja, do të përhapet mirësia dhe do të pakësohen mëkatet. Kur ndodh kjo, do të thotë se na ka ndihmuar Allahu në veten tonë, siç ka treguar në librin e Tij: *"...Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm. (Allahu ndihmon edhe) Ata, të cilëve nëse u japim pushtet në tokë, kryejnë faljet, japin zekatin, urdhërojnë kryerjen e veprave të mira dhe pengojnë atë që është e mbrapshtë. Tek Allahu është fundi i të gjitha çështjeve."* El-Haxh: 40-41

3- Allahu do të na mëshirojë me mëshirën e Tij në këtë dhe botën tjetër, siç ka thënë Allahu i Lartësuar: *"Besimtarët dhe besimtare të jenë miq për njëri-tjetrin. Ata urdhërojnë që të bëhen vepra të mira dhe i ndalojnë të këqijat; falin namazin, japin*

zekatin dhe i binden Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Këta janë ata që do t'i mëshirojë Allahu..." Et-Tevbe: 71

4- Allahu do ta largojë dënimin prej nesh, siç thotë në Kur'an: *"Por, kur e harruan atë për të cilën ishin paralajmëruar, Ne i shpëtuan ata që këshillonin."* Këta janë që urdhërojnë në të mirë dhe ndalojnë nga e keqja. *"Kurse i ndëshkuam ashpër keqbërësit, për shkak të mosbindjes së tyre."* El-Araf: 165

5- Do të jemi të shpëtuar në këtë botë dhe në tjetrën. Allahu i Lartësuar thotë: *"Le të dalë prej jush një grup që të thërrasë për në mirësi, të urdhërojnë për vepra të mira e të ndalojnë prej veprave të shëmtuara! Këta njerëz do të jenë të shpëtuarit."* Alu Imran: 104)

*Ebu Islam, Salih ibën Taha ABDULVAHID
Absenul-Bejan min mevakif Ehlul-Iman*

Përshtati: Sabahudin SELIMI

Viti / Kosovë



PËRGJIGJE TË QARTA NDAJ DYSHIMEVE ME TË CILAT ARGUMENTOHET LEJIMI I MEVLUDIT

P J E S A E P E S T Ë

Mevludin nuk e kanë praktikuar as sahabët, as tabi'inët dhe as muslimanët në shekujt e parë të zgjedhur. Si mund të jetë kjo prej veprave të mira?

DYSHIMI I SHTATË

Mevludi është një gjë që e kanë konsideruar të mirë dijetarët dhe muslimanët në të gjitha vendet dhe është praktikuar në çdo rajon. Një gjë e tillë është e kërkuar fetarisht sipas rregullit të përfutur nga hadithi mevkuf ^[1] i Ibën Mes'udit, që thotë: "Atë që muslimanët e shohin për të mirë, ajo tek Allahu është e mirë." ^{[2][3]}

PËRGJIGJJA NDAJ KËTIJ DYSHIMI

1. Ky mendim kundërshton të vërtetën. Dijetarët e mëdhenj të selefit e kanë mohuar mevludin dhe kanë thënë se është bidat dhe kundërshton atë që i ka zbritur Pejgamberit sal-IAllahu alejhi ve sel-lem. Çdo gjë që kundërshton diçka nga Sunneti i Resulullahut alejhi selatu ve sel-lem, nuk ka vend as peshë, por në realitet është e refuzuar me argument nga fjala e Pejgamberit salavatullahi ve selamuhu alejhi: "*Kush shpik në fenë tonë çfarë nuk është prej saj,*

[1] Hadithi mevkuf është ai hadith senedi i të cilit nuk arrin deri te Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, por arrin vetëm deri te sahabi dhe ky lloj hadithi është prej llojeve të dobëta (daife).

[2] Shiko Musnedu Imam Ahmed 1/379. Ky hadith është mevkuf- me sened deri tek Ibën Mes'udi. Disa që e praktikojnë mevludin, e konsiderojnë merfû, pra që senedi arrin deri tek Pejgamberi sal-IAllahu alejhi ve sel-lem, mirëpo kjo nuk është e vërtetë. Ibën Hazmi për këtë në librin e tij El Ihkamu fi Usulil-Ahkam 2/197 thotë: "Për këtë hadith nuk dimë sened deri tek Resulullahu sal-IAllahu alejhi ve sel-lem në asnjë aspekt. Ajo që nuk ka aspak dyshim është se për këtë nuk gjendet kategorikisht në Musnedus-Sahih, por ne e dimë këtë nga Ibën Mes'udi." Shiko edhe Mekasidul hasene nga Sehavi 367, Keshful Hafa' nga Axhluni 2/263 dhe Silsiletu Ehadithud-Daifeh nga Albani 2/17.

[3] Havlel Ihtifalu bil Mevludi 12 dhe Edh-Dhehairul Muhammedijeh nga Muhammed Alevi Malikij 270-271.

është e refuzuar."^[4]

Allahu subhanehu ve te ala thotë: *"...e atë që ju jep Pejgamberi merreni e atë që ju ndalon largojuni..."* Hashër: 7. Po ashtu thotë: *"... Sot Unë përsosa për ju fenë tuaj, ju plotësova begatitë dhe jam i kënaqur që për ju zgjodha Islamin fe."* El Maide: 3.

Mevludin nuk e kanë praktikuar as sahabët, as tabi'inët dhe as muslimanët në shekujt e parë të zgjedhur. Si mund të jetë kjo prej veprave të mira?

2. Nyja shquese el te fjala el muslimun-muslimanët, ka për qëllim kohën dhe këtë e aludon teksti i thënies: "Vërtet Allahu shikoi në zemrat e robërve dhe e zgjodhi Muhamedin dhe e dërgoi me shpalljen e Tij. Pastaj shikoi në zemrat e robërve pas zemrës së Muhamedit dhe vërejti zemrat e sahabëve, zemrat më të mira prej robërve dhe i bëri shokë të Pejgamberit të Tij që luftojnë për fenë e tij. Çfarë të shohin muslimanët për të mirë, ajo tek Allahu është e mirë dhe çfarë e shohin për të keqe, ajo tek Allahu është e keqe." Qëllimi i këtij etheri nga sahabi është konsensusi i sahabëve dhe pajtueshmëria e tyre. Për këtë aludon ajo që është transmetuar tek Hakimi me shtesë: "Të gjithë sahabët e panë që t'u bëhet kalif Ebu Bekri radijallahu anhu."^[5] Në këtë thënie sqarohet qëllimi dhe Abdullah ibën Mes'udi radijallahu anhu ka argumentuar me këtë për kalifatin e Ebu Bekrit me konsensusin e sahabëve.

3. Nëse thuhet se vërtet nyja shquese el përfshin të gjithë muslimanët dhe atëherë

kjo është ixhma, dihet se kompetentë për ixhma janë muxhtehidët dhe dijetarët. E nëse nuk janë për qëllim ata që janë kompetentë për ixhma, atëherë do të thotë se edhe populli i thjeshtë që nuk ka dituri merret për argument në atë që e sheh për të mirë, e kjo është gjë e rrefuzuar me konsensus.^[6]

Iz ibën Abduselam kur është pyetur për këtë ka thënë: "Nëse vërtetohet hadithi, fjala muslimanët ka për qëllim kompetentët e ixhmasë."^[7]

Me këtë sqarohet se nuk ka argument nga ky fakt për praktikuesit e mevludit, kur dihet se Abdullah ibën Mes'udi radijallahu anhu ishte më i rrepti prej sahabëve që kundërshtonte dhe mohonte bidatet si dhe i bojkotonte pasuesitë e tij dhe sahabi i cili ka thënë: "Pasoni e mos shpikni, ju mjafton (pasimi)..."^[8] Kur ata nuk gjetën argument të saktë për festimin e mevludit, deklaruan se kjo gjë është bidat i mirë, duke e mbrojtur e ndihmuar, duke i bërë kështu padrejtësi argumenteve, të cilat i vendosën aty ku nuk e kanë vendin, duke devijuar domethëniet e vërteta të argumenteve dhe duke kundërshtuar kështu metodologjinë e të parëve të këtij ummeti. Kur vërtetohet se kjo gjë është bidat dhe është ashtu siç kanë dëshmuar për këtë edhe ata vetë, duhet të kemi parasysh fjalën e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *"...çdo bidat është devijim..."* Kjo përfshin çdo bidat dhe nuk ka në legjislacionin islam bidat të mirë,^[9] madje bidati mohon

[4] Transmetojnë imam Buhariu në Sahihun e tij, Kitabul Sulh 2/112 dhe në Kitabul I'tisamu bil Kitabi ve Sunneh 4/268, imam Muslimi në Sahihun e tij, Kitabul Akdijeh bab nakdul Ahkamul Batileh ve rred Muhdethatul Umur 3/1343-1344, nr. 1718.

[5] Shiko Mustedrekun e Hakimit, Kitabu Mearifetus-Sahabeh 3/78-79, dhe thotë se hadithi është sahih dhe me këtë pajtohet Dhehebiu.

[6] Shiko El I'tisam nga Shatibiu 2/152, El Ihkam fi Usulil Ahkam nga Ibën Hazmi 2/197, Silsiletul Ehadithud-Daifeh nga Albani 2/18-19, El Bid'atu ve Etheruha es-Sejji' nga Selim Hilali 21-22 dhe Usulun fis-Suneni vel Bidai nga El Adevi 39-40.

[7] Shiko Kitabul Fetava nga El Iz ibën Abduselam 42.

[8] Transmeton Ebu Hajthemeh në El Ilmë numër 54 nga rruga (e transmetimit) e Ibrahim en Nehaij; thotë: "Ka thënë Abdullahu". Ky sened është sahih për çka është e njohur nga Ibrahim në këtë formë se ky është (transmetuar) edhe nga të tjerë nga Ibën Mes'udi.

[9] Referojnë fushotës 8 në numrin e 21 PËRGJIGJE TË QARTA NDAJ DYSHIMEVE ME TË CILAT ARGUMENTOHET LEJIMI I MEVLUDIT Dëlirje & Edukim..

Sunnetin dhe të mirën. Nuk kemi nevojë për ndonjë vepër si kjo, të cilën nuk e ka praktikuar Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe asnjë prej shekujve të zgjedhur që i ka lavdëruar Resulullahu sal-lAllahu alejhi ve sel-lem prej sahabëve, tabi'inëve dhe tabi tabi'inëve, të cilët janë njerëzit më të mirë, më vigjilentë e më të përkushtuar në pasimin e Sunnetit të Pejgamberit alejhi selatu ve sel-lem. Hoxha i Islamit Ibën Tejmije thotë: "Është e ditur se çdo gjë që nuk e ka bërë sunnet dhe as nuk e ka pëlqyer Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem si dhe asnjë prej atyre që muslimanët i kanë shembull në fenë e tyre, atëherë ajo gjë është bidat dhe askush nuk thotë se është bidat i mirë.^[10] E kush thotë se ka bidat të mirë, ai vetëm ka pretenduar se ka sjellë në këtë fe diçka më të mirë sesa ajo që ka sjellë Pejgamberi sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe shokët e tij radijallahu anhum dhe se Pejgamberi alejhi selatu ve sel-lem nuk e ka treguar shpalljen e Zotit të tij. Me këtë pretendim ata kundërshtojnë tekstin e fjalës së Allahut az-ze ve xhel: *"Sot Unë përsosa për ju fenë tuaj, ju plotësova begatitë dhe jam i kënaqur që për ju zgjodha Islamin fe."*, Maide: 3, Siç thuhet: Çdo e mirë është në pasimin e selefit Dhe çdo e keqe është nga shpikjet e halefit.^[11]

O ju që festoni lindjen e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi ve sel-lem! A nuk ju mjafton ajo që punuan dhe porositën Resulullahu alejhi selatu ve sel-lem e shokët e tij radijallahu anhum? A nuk i frikësoheni Allahut

subhanehu ve te ala, i Cili thotë: *"...le të ruhen ata që kundërshtojnë rrugën e tij (të të Dërguarit), se ata do t'i zërë ndonjë telash ose do t'i godasë dënim i hidhur."*, Nur: 63. E nëse festoni ditën që lindi Pejgamberi salavatull-llahi ve selamuhu alejhi, kjo ditë është edhe dita në të cilën vdiq, prandaj gëzimi nuk ka përparësi para mërziisë në këtë ditë!^[12]

Ky sqarim dhe elaborim i mjaftueshëm sqaron se pasuesit e bidatit janë pasues të dëshirave të gabuara dhe ndoshta ishin nga ata që përmirësuan, porse çfarë paraqiten nga dyshimet që i pretenduan për argumente mbi vërtetimin e bidateve të tyre, ato vërtetë ishin dyshime të dobëta që nuk të forcojnë dhe ato përballë argumenteve të qarta, shariatike, janë iluzione dhe nuk ka të vërtetë në to, janë si rrjeti i merimangës, pa qëndrueshmëri: *"...dhe vërtet më e dobëta shtëpi është shtëpia e merimangës."* Ankebut: 41.

Kush mediton me të menduar të shëndoshë dhe bëhet hulumtues i së vërtetës, do të udhëzohet i bindur në atë se kjo vepër është bidat. Kush është pasues i dëshirave të devijuara dhe thirrës në devijim, argumentet dhe sqarimet e bazuara në argumente nuk do t'i shtojnë asgjë tjetër pos mohim e mendjemadhësi ndaj së vërtetës. Allahu na mbrojtë nga kjo gjë e shëmtuar, se kë e devijon Allahu, për atë nuk do të ketë udhëzues.

*Adem AVDIU
Gjakovë / Kosovë*

[10] Shiko Mexhmu'ul fetava 27/152.

[11] Selefi janë të parët tanë të devotshëm – shekujt e zgjedhur dhe ata që i pasuan këta drejt, ndërsa halefi quhen ata që i kundërshtuan këta, pa marrë parasysh a jetuan në kohën e tyre apo pas.

[12] Shiko El Mevredü fi Amelil- Mevlidu nga Fekhani 26-27 dhe Med'hal nga Ibnul Haxh 2/15.



FEMRA

dhe kurthet e armikut

-III-

Islami synon që mashkulli të ruajë burrërinë e tij dhe prandaj ia ka ndaluar arin dhe mëndafshin. Gjithashtu synon që femra të mbetet femër dhe për këtë arsye ia ka ndaluar asaj që të përzihet me burrat e huaj.

MMe të vërtetë falënderimet i takojnë Allahut, vetëm Atë e falënderojmë dhe vetëm prej Tij ndihmë dhe falje kërkojmë. Atë që e udhëzon Allahu nuk ka kush ta humbasë dhe atë që e humbë nuk ka kush ta udhëzojë përveç Tij. Dëshmoj dhe deklaroj se nuk meriton të adhurohet askush pos Allahut dhe dëshmoj dhe deklaroj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij.

“O ju njerëz! Kini frikë Zotin tuaj, që ju ka krijuar prej një veteje (njeriu) dhe nga ajo krijoi palën (shoqen) e saj, e prej atyre të dyve u shtuan shumë burra e gra. Dhe kini frikë Allahun, që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni furefisn (akraballëkun), se Allahu është mbikëqyrës mbi ju.” En-Nisa: 1.

E katërta: Thirrja për barazi gjinore Fillimisht mund të themi se thirrja për barazi gjinore është në kundërshtim me natyrshmërinë e krijimit të gjinive sepse secila gjini nuk mund të barazohet me tjetrën dhe se jeta do të shkatërrohej nëse kërkohet një gjë e tillë. Edhe ligjet e vendosura nga vetë njerëzit janë të ndërtuara në kontrast me këtë. Nëse nuk mund të ketë barazi mes burrave, si mund të ketë barazi mes burrave dhe femrave?

Ne nuk besojmë që mund të ketë barazi absolute, por besojmë se mund të ketë në disa aspekte barazi mes femrës dhe mashkullit. Kjo duhet të quhet drejtësi dhe jo barazi.

a) Femra është e barabartë me mashkullin

në bazat e obligimeve të sheriatit, por me disa ndryshime të vogla në mes tyre.

b) Femra është e barabartë me mashkullin në shpërblim dhe ndëshkim në këtë botë dhe në tjetrën: *"Besimtarët dhe besimtarët janë të dashur për njëri-tjetrin, urdhërojnë për të mirë, e ndalojnë nga e keqa, e falin namazin dhe japin zekatin, respektojnë Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Të tillët do t'i mëshirojë Allahu. Allahu është Ngadhënyjes, i Urtë."*

Et-Tevbe: 71.

c) Femra është e barabartë në marrjen e hakut të saj.

d) Femra është e barabartë në posedimin e pasurisë dhe shpenzimin sipas dëshirës së saj.

e) Femra është e barabartë në zgjedhjen e bashkëshortit të saj dhe nuk detyrohet për atë që nuk e dëshiron.

Islami synon që mashkulli të ruajë burrërinë e tij dhe prandaj ia ka ndaluar arin dhe mëndafshin. Gjithashtu synon që femra të mbetet femër dhe për këtë arsye ia ka ndaluar asaj që të përzihet me burrat e huaj.

E përfundojmë këtë pikë me dëshminë e një thirrëse të barazisë gjinore, e cila flet prej përvojës dhe vuajtjeve që ka pasur pas një kohe të gjatë në kërkimin e lirive dhe barazisë gjinore të pretenduar. Lejla Uthman thotë. "E pranoj sot se unë nuk pajtohem me shumë gjëra që i quajmë "emancipim të femrës". Ky emancipim është në llogari të nderit të saj dhe në llogari të shtëpisë dhe fëmijëve të saj.

Them se e kam ngarkuar veten ashtu siç veprojnë shumë gra të tjera, duke ngritur flamurin e barazisë gjinore." Pastaj përmend se i ndodh të ballafaqohet me

padrejtësi dhe keqtrajtim nga mashkulli, mirëpo e lavdëron atë dhe thotë se kjo nuk duhet ta shtyjë që të refuzojë natyrshmërinë që i ka dhuruar Zoti dhe të bëhet grua me mustaqe e të ballafaqohet me mashkullin. "A do të thotë kjo që unë të ballafaqohem me të dhe të bëj atë që bën mashkulli, qoftë e ndaluar apo e lejuar, vetëm që të realizoj qëllimin tim? Askush nuk është më i mirë se tjetri, jemi të barabartë dhe të lirë ashtu siç na kanë lindur nënat tona. A do të thotë kjo që unë ta shikoj shtëpinë ashtu siç mendojnë shumë gra, se shtëpia është burgu i përjetshëm dhe se fëmijët nuk janë tjetër veçse litar i lidhur në qafën time, kurse bashkëshorti veçse një gardian i rreptë burgu që më lidh këmbët nga frika se po ia kaloj?! Jo, unë jam femër dhe krenohem që jam e tillë! Unë jam grua dhe krenohem me ato që më ka dhuruar Allahu. Jam amvise e pastaj nuk ka problem nëse bëhem punëtoresh jashtë familjes sime, mirëpo o Allah dëshmo, së pari shtëpia ime, pastaj shtëpia ime, pastaj shtëpia ime dhe pastaj bota." [1]

E pesta: Thënia e tyre e gabuar

Pastërtia është sjellje që buron nga shpirti i pastër, i cili e urren të keqen dhe dëmin. Hixhabi dhe largimi nga burrat e huaj nuk do të thotë që është e patjetërsueshme që muslimanja të jetë e pastër nga këto ndaluara.

Vëlla i dashur!

Në këtë shkrim nuk mund ta parashtroj çështjen e hixhabit gjerësisht, por do të përmend disa gjëra.

1- Për hixhabin ka argumente të shumta

[1] Risaletun ila hava 4/46.

nga Kur'ani dhe Sunneti, siç është fjala e Allahut: *"O ti Pejgamber, thuaju grave të tua, bijave të tua dhe grave të besimtarëve, le të vënë shamitë (mbulojë) e veta mbi trupin e tyre."* El Ahzab: 59.

"E kur kërkonit prej tyre (grave të Pejgamberit) ndonjë send, atë kërkojeni pas perdes." El Ahzab: 53.

"Le të vënë shamitë mbi kraharorin e tyre." Nur: 31.

2. Ka citate të shumta që argumentojnë për ndalimin e përzierjes së burrave me gra. Hadithi që transmeton Ebu Hurejra thotë se *"safi më i mirë për burrat është i pari dhe më i keqi ai i fundit, kurse safi më i mirë për gratë është i fundit dhe më i keqi ai i pari."*^[2]

Nafiu transmeton nga Ibën Umeri radijallahu anhum, se i Dërguari i Allahut salallahu alejhi ve sel-lem ka thënë: *"Sikur ta kishin lënë këtë derë vetëm për gra?"*

Nafiu ka thënë se nuk ka hyrë Ibën Umeri në atë derë derisa ka vdekur."^[3]

3. Në përzierjen e femrave dhe të meshkujve dhe në zbulimin e tyre ka shumë dëme fetare dhe jofetare:

a) është mëkat ndaj Allahut dhe të Dërguarit të Tij

b) sjell mallkim dhe largim nga mëshira e Allahut

c) ndihmon në përhapjen e amoralitetit në shoqëri

d) përngjasim me çifutët dhe ata që shpejtojnë në përhapjen e fesadit në tokë.

Zbulimi dhe përzierja e femrave me meshkuj shkaktojnë shumë dëme, bëhen shkak për krime të shumta, për prishjen e lidhjeve familjare, për trafikimin e saj, për përhapjen e sëmundjeve të ndryshme sek-

suale etj.

Ne nuk themi se çdo grua e mbuluar është e mbrojtur nga amoraliteti, kurse çdo grua e zhveshur është amorale, por pyesim se çfarë e ka shtyrë të bjerë në amoralitet një femër të mbuluar, a është mbulesa apo dobësia e imanit të saj? Ajo që e ka mbrojtur një femër të zhveshur nga amoraliteti është imani apo zhveshja e saj?

Me të vërtetë hixhabi është prej ndihmësve me të mëdhenj të femrës për ruajtjen e saj. Hixhabi e mbron atë nga sytë e këqij, nga shikimi i amoralitetit.

E përfundojmë këtë pikë me fjalën e gazetares amerikane Hilsjan Stansbery pas qëndrimit të saj në Kairo. Ajo është kthyer në vendin e vet dhe ka deklaruar: "Me të vërtetë shoqëria islame është e plotësuar dhe e shëndoshë. Kjo shoqëri pason traditat e saj, të cilat i kufizojnë femrat dhe meshkujt në një kufizim të logjikshëm. Kjo shoqëri ndryshon nga ajo amerikane dhe evropiane. Ajo ka edukatë të trashëguar që kërkon kufizimin e gruas, kërkon respektin ndaj nënës dhe babait, kërkon edhe më shumë, moslejimin e shfrenimit perëndimor, i cili e shkatërron shoqërinë dhe familjen në Evropë dhe Amerikë.

Shoqëria amerikane është kthyer në një shoqëri të stërmbytur me foto të amoralshme dhe të turpshme. Viktimat e përzierjes së femrave me meshkujt mbushin burgjet, baret dhe shtëpitë publike. Liria që u dhamë vajzave tona dhe djemve tanë të vegjël i ka bërë ata gangsterë, mafiozë dhe robër të drogës."^[4]

[2] Transmeton Muslimi (440), Ebu Davudi (678), Tirmidhiu (224), Nesaiu (2/93).

[3] Ebu Davudi (571). Albani thotë se është sipas kushteve të Buhariut dhe Muslimit.

[4] Risaletun ila heva (4/98).

E gjashta: Politika graduale e tyre
Duke përdorur metodën graduale ata nuk
kërkojnë nga shoqëria që të bëjë kthesë
menjëherë, pasi nuk do të mund ta reali-
zonin një gjë të tillë, mirëpo punojnë hap
pas hapi në realizimin e qëllimeve të tyre.

E shtata: Dituria

Më vjen keq që po e përmend dijen dhe
mësimin si strategji dhe kurth të armiqve,
mirëpo ata e përdorin për t'u futur aty ku
dëshirojnë.

Dituria në Islam është prej veprave më të
mira dhe këtë nuk e mohon askush,
vetëm ndonjë injorant ose arrogant. Të
gjitha citatet nga Kur'ani dhe Sunneti nx-
isin për dituri dhe përfshijnë edhe
meshkujt edhe femrat, siç thotë Allahu:

***“Thua: “A janë të barabartë ata që dinë
dhe ata që nuk dinë?”*** Ez-Zumer: 9.

Në kohën e Pejgamberit sal-lAllahu alejhi
ve sel-lem, gratë kanë kërkuar një ditë të
caktuar për t'u dhënë mësim atyre dhe ka
pasur prej tyre që kanë korrur sukses dhe
janë bërë dijetare, siç ishte Ajshja radijal-
lahu anha. Për të Abdulberri ka thënë se
ishte e vetmja grua që ka ditur jurispru-
dencën (fikhun), mjekësinë dhe poezinë.
Mjafton të dimë se Ibën Saadi ka përr-
mendur në librin e tij Tabakatul kubra
mbi shtatëqind femra të cilat kanë trans-
metuar hadithe nga i Dërguari i Allahut
sal-lAllahu alejhi ve sel-lem dhe kanë
transmetuar prej tyre shumë meshkuj.
Sinqeriteti dhe mbajtja e amanetit prej
tyre ka qenë e veçantë, saqë Dhehebiu ka
pohuar se nuk di që ndonjë grua që ka
transmetuar hadithe të jetë akuzuar^[5] apo
të jetë lënë.^[6]

Armiqtë e Islamit i kanë shfrytëzuar këto
citete të Islamit dhe i kanë bërë barazuar
metodat e të mësuarit të femrave dhe të
meshkujve, ashtu si edhe nivelet e tyre të
arsimimit.

Sigurisht që një pjesë e diturisë është e
përbashkët dhe ajo është dija e obliguesh-
me në përmirësimin e besimit, adhurimit
dhe etikës, mirëpo ka metoda që i përsh-
taten femrës në rolin e jetës së saj dhe ka
metoda që i përshtaten mashkullit.

Cilat janë metodat që u mësojnë femrave
tona pozitën e femrës në Islam dhe
largimin nga dyshimet?

Cila është metoda që e forcon lidhjen e
gruas me shtëpinë e saj dhe tregon pozi-
tën e vërtetë të femrës, jo ashtu siç e
pasqyrojnë armiqtë e Islamit?

Femra është e urdhëruar që ta mbrojë
trupin e fëmijës së saj dhe ta ushqejë me
ushqim të shëndetshëm. Femra ka nevojë
që t'i studiojë sjelljet e fëmijëve të saj fizi-
kisht dhe psikologjikisht dhe të dijë si të
veprojë në situata të ndryshme.

Unë nuk them se këto studime janë
anashkaluar në tërësi në universitete, por
them se nuk studiohen në mënyrën e
duhur dhe në nivelin e kërkuar.

Dr Abdullah ibën Vekil ESH SHEJH

“Elmeretu ve kejdul e'ada “

Përshtati: Eshrefedin ISMAJLI

Viti / Kosovë

[5] Nuk i është pranuar transmetimi.

[6] Mizanul i'atidal (4/604).



MIRËSIA E DUASË

Robi ka nevojë për dua ashtu që ta përmirësoj fenë e tij, dunjanë dhe ahiretin e tij, dhe përmirësimin e tër gjendjës së tij, thotë Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, me një dua tjetër: "...Ma përmirëso tërë gjendjën time"

Së pari po fillojmë me shpjegimin e disa prej mirësive të duasë, pozitës së sajë në legjislacionin islam, si dhe rëndësis së saj në këtë fe të pastërt, e njashtu edhe pozitës së saj në librin e Allahut, azze ve xhel-le, dhe sunnetin e Pejgamberit, salAllahu alejhi ve sel-lem.

E kush e shfleton Kur'anin, e gjenë se me të vërtetë libri i Allahut është i mbushur përplot me ajete- citate të cilat tregojnë për mirësit e duasë dhe pozitën e lartë të sajë, ngase ti kur lexon Kur'an e gjenë se sureja e parë me të cilën hapet libri i Allahut, azze ve xhel-le, "fatihatu el-kitab", përfshin në vete këtë ibadet-adhurim të madhë, e njashtu edhe (sureja e fundit në Kur'an) fundi i Kur'anit përfsh-

inë këtë ibadet të madhë, andaj shihet qartë se libri i Allahut fillon dhe përfundon me dua,

Duaja e cila gjendet në "fatihatu el-Kitab" është prej duave më me vlerë në përgjithësi. Aty kërkohet prej Allahut udhëzim për në rrugën e drejtë, dhe që ta largoj robin nga rrugët e të humburve dhe atyre me të cilët Allahu është i hidhëruar, e njashtu edhe në suren e fundit të librit të Allahut kërkohet mbrojtje prej Allahut që ta mbroj prej të keqës se cytesit që fshihet, i cili bënë cytje në zemrat e njerëzve, qoftë ai (cytesi) nga xhinët ose nga njerëzit, i cili kërkon që ti largoj ata prej rrugës së drejtë dhe mirëfillt.

"Mandej do t'ju sillem atyre para, prapa,

nga e djathta dhe nga e majta e tyre, e shumicën e tyre nuk do ta gjesësh që të falënderohen (të besojnë)!” El-Araf:17

Andaj nuk ka përqëndrim në rrugën e drejtë dhe as shpëtim prej shejtanit i cili i thërret njerëzit që të devijojnë nga kjo rrugë (e drejtë) vetëm se me dua, dhe kërkim mbrojtje prej Allahut, dhe kthim të mirë tek Ai.

Pra ky fillim dhe mbarim sinjalizon për rëndësinë e duas në një anë, dhe nevojën e madhe të njerëzve për të (dua) ashtu që ti forcoj Allahu në rrugën e drejtë.

E nëse i mediton ajetet e tjera në Kur'an e gjenë se pozita e duasë në Kur'an është e lartë dhe me rëndësi të madhe, gjenë shumë ajete të cilat urdhërojnë dhe nxisin për dua, të cilat sqarojnë mirësitë dhe pozitën e sajë të lartë, dhe atë qfar ka përgatitur Allahu, tebareke ve tealë, shpërblime të mëdha, sevape të shumta, si dhe të mira të përgjithshme (qofshin ato të mira) të dunjas apo të ahiretit.

Në Kur'an gjen thirrje të pejgamberëve, njerëzve të mirë të cilët janë të kapur mirë për fenë e Allahut, xhel-le ve alë: *”Ata përpiqeshin për punë të mira, na u luteshin duke shpresuar dhe duke u frikësuar, ishin rrespektues ndaj nesh”* El-Enbija:90

”I heqin trupat e tyre prej dyshekëve, duke e lutur Zotin e tyre nga frika dhe nga shpresa...” Es-Sexhdeh: 16

”Perkufizojë vetën tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij...” El-Kehf:28

Allahu, azze ve xhel-le, i ka lavdëruar pejgamberët dhe njerëzit e mirë prej robërve të Tij; përshkak kujdesit dhe rëndësisë së tyre që i kushtuan duasë dhe kthimit të

tyre të mirë dhe të drejtë kah Allahu, xhel-le ve alë, na lajmëroi në këto ajete se Ai iu është përgjigjur atyre, dhe se Ai, subhanehu ve tealë, i përgjigjet atij që i lutet, dhe i jep atij që kërkon prej Tij, e nuk e refuzon asnjë besimtar që kërkon prej Tij, ”Zoti i juaj ka thënë: *”Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem...”* ” Gaafir:60

”E kur robët e Mij të pyesin ty për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet...” El-Bekareh:186

”Zoti im ndëgjon dhe i përgjigjet lutjes” Ibrahim:39

Allahu, subhanehu ve tealë, me këtë po na lajmëron për vetëvetën e Tij, se me të vërtetë u përgjigjet lutjes kur lutësi i lutet, dhe se ai është afër, ndëgjon dhe përgjigjet, xhel-le ve alë,.

E tëra kjo na jep të kuptojmë pozitën e duasë në kur'an, dhe se ajo është ibadet-adhurim i madh dhe i dashur tek Allahu, xhel-le ve alë, dhe Ai, subhanehu ve tealë, e don atë prej robërve të Tij, i don prej tyre lutjet e shumta nënshtrimin-përluljen (frigërrespektin), kthimin tek Ai dhe kërkimin prej Tij, e don prej tyre që duaja të jet mes robërve dhe Allahut në heshtje pa e ndëgjuar (dhe parë) as kush tjetër përveq Tij, thotë Allahu në Kur'an:

”Luteni Zotin tuaj të përulur e në heshtje, pse Ai nuk i do ata që e teprojnë, mos bëni qrrregullime në tokë pas rregullimit të sajë (me të ardhur të pejgamberëve) dhe luteni atë duke pasur frikë (dënimin) dhe duke shpresuar mëshirën). S'ka dyshim se mëshira e Allahut është pranë atyre të mirëve”. El-

Araf:55-56

E tërë kjo na bën të kuptojmë pozitën e lartë që ka duaja në librin e Allahut, azze ve xhel-le.

E gjithashtu edhe nëse shiqojmë në sunnetin e Pejgamberit fisnik, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, në historinë e tij të mirë, në udhëzimin e tij të drejtë; e gjejmë pozitën e lartë të duasë dhe lidhjen e saj të ngushtë me jetën e tij, thirrjen e tij, siren e tij, dhe udhëzimin e tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, e për këtë janë të shumta hadithet të cilat janë transmetuar prej tij, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, të cilat tregojnë për mirësit e duasë dhe pozitën e saj tek Allahu, xhel-le ve ala dhe se duaaja është ibadet fisnik dhe madhështor, nënshtrim i plotë, të cilin Allahu, subhanehu ve tealë, e don për robërit e tij.

E nga ajo që është transmetuar është; ajo që është vërtetuar nga Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, se ka thënë:

"Kush nuk kërkon prej Allahut, Allahu hidhërohet me të".^[1] Medito Allahu të ruajt këtë hadith që tregon për mirësinë e duasë, dhe pozitën e lartë të saj tek Allahu dhe dashurinë që ka Allahu për të: *"Kush nuk kërkon prej Allahut, Allahu është i hidhëruar me të"*, kjo jep të kuptojmë se duaaja është e dashur tek Allahu dhe se Allahu don që të dëgjoj prej robërve të tij thirrjet e tyre (drejtuar Allahut), kthimin tek Ai, kërkesat dhe lutjet e tyre, e njashtu kërkon prej tyre që të jenë këmbëngulës në të.

Allahu hidhërohet kur ti prej Tij nuk kërkon.

E birin e Ademit kur kërkon prej tij, atë e hidhëron.

Biri i Ademit kur kërkohet prej tij hidhërohet; e nëse kërkon më shumë ai edhe më shumë hidhërohet, miëpo Allahu krijuesi fisnik, subhanehu ve tealë, me të

vërtetë hidhërohet kur robi nuk kërkon prej Tij, ngase moskërkesa e robit (prej Allahut) ngërthen në vete një lloj mendjemadhësie. Allahu në Kur'an thotë, *"Zoti juaj ka thënë: "Më thirrni Mua, Unë ju përgjigjem, e ata që nga mendjemadhësia i shmangën adhurimit ndaj Meje (lutjesime), do të hyjnë të nënqmuar në xehenem"* Gafir:60

Si tërhiqet robi prej lutjes së Allahut dhe tregohet mendjemadhë, e nevoja e tij për dua- lutje dhe kërkim (prej Allahut) është shumë e madhe?! Kur ai është i varfër-nevojtar për Allahun në çdo sferë (të jetës së tij), nuk mundë të mos ketë nevojë për Zotin e tij sa qelë e mëshel sytë, e për asnjë qastë prej qasteve, nevojtarë për Allahun në ushqimin e tij, në të pirit, në të veshurit, në udhëzimin e tij për kah rruga e drejtë, nuk mundë të përmiresohet as feja e tij, as dunjaja e as ahireti i tij, vetëmse me pëlqimin dhe mirësinë e Allahut, subhanehu ve tealë, andaj si tregohet mendjemadhë kur është i varfër për zotin e tij në qdo sferë të jetës?!

Medito kuptimin e fjalës së Allahut në këtë hadithë kudsij, hadithin e Ebu Dherrit në "Sahihu Muslim", thotë Allahu, xhel-le ve ala: *"O robërit e Mij! Të gjithë jeni të humbur përveq atij të cilin unë e kam udhëzuar, andaj kërkon i udhëzimi prej meje ashtu që unë t'ju udhëzoj juve, O robërit e Mij! Të gjithë ju jeni të uritur, andaj kërkon i ushqimi prej meje ashtu që Unë t'ju ushqej juve, O robërit e Mij! Të gjithë ju jeni të zhveshur, andaj kërkon i mbuloj (veshje) prej Meje që unë t'ju mbuloj (veshi) juve, O robërit e Mij! Me të vërtetë ju gaboni ditë dhe natë e Unë i*

[1] Transmeton Ahmedi në Musnedin e tij (1/443,477), "sunen et-Tirmidhi" (3373), "iben Maxheh" (3827), dhe ka thënë ibën Kethiri se isnadizinxhiri i këtij hadithi nuk ka dert në të,"et-Tefsir" (3/92), ndërsa Albani këtë hadith e ka cilesuar si të mirë në"es-Sahihā" (2654), me testin:" Kush nuk i lutet Allahut, Allahu hidhërohet me të"

*fali te gjitha mëkatet , andaj më kërkoni
Mua falje ashtu që Unë t'ua falë"*

E pastaj thotë-tebareke ve tealë,-në këtë
hadith el-Kudsij: *"O robërit e Mij! Sikur i
pari dhe i fundit prej juve , njerëzit dhe
xhinët, ngritën me një vendë të hapur për
t'më kërkuar Mua diqka, do ti jap çdo se-
cilit atë që kërkon, e kjo nuk e pakëson atë
që është tek Unë sikurse nuk pakëson
gjilpëra(prej ujit të detit) nëse futet në
det".*^[2]

Të mirat e Allahut, tebareke ve tealë, janë
të shumta dhe të shumta, thotë pejgam-
beri, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *"Dora e
Allahut (e djathta e Tij) është shumë e
pasur (e pafund), nuk e pakëson atë
asgjë(edhe pse) ajo rrjedh (derdhët) ditën
dhe natën, a keni parë atë që është dhënë
prej kur janë krijuar qiejt dhe toka, me të
vërtetë ajo nuk pakëson (asgjë) nga ajo që
është në të djathtën e Tij"*^[3]

***"Ajo që e keni pranë vetës është e
përkohshme, e ajo që është te Allahu është e
përvetshme..."*** En-Nahl:96

Të dhënurit e Tij, subhanehu ve tealë,
është fjalë, e edhe ndalimi i Tij është
fjalë.^[4]

***"Kur Ai dëshiron ndonjë sendë, urdhëri i
Tij është vetëm ti thotë: "Bëhu!" Ai men-
jëher bëhet".*** Jasir:82

Kjo është gjendja e Tij,subhanehu ve
tealë, andaj si mundë që robi të tregohet
mendjemadhë dhe të tërhiqet në të lutu-
rit (të bërit dua) Zotit të tij, është negli-
zhent në të kur dihet se është i varfër dhe

nevojtarë për Zotin e tij për çdo gjë?!

I varfër dhe nevojtar për Allahun që t'ia
përmirësoj ushqimin e tij, të pirit, të
veshurit,banimin, dunjan dhe ahiretin e
tij. Medito këtë në porosinë e Pejgam-
berit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, Ajshes,
radijAllahu anha,- hadithi është në
"Musnedin" e Imam Ahmedit dhe të
tjerët,thotë: *"Oj Ajshë! Bëri duat e plota",
e në një transmetim tjetër: "Bëri duat më
përmbledhëse:"*^[5] *"O Zot! Kërkoj prej Teje të
gjitha të mirat, (qofshin ato) të përshpejtu-
ara apo të vonuara, ato që unë i diç apo
nuk i diç, dhe kërkoj mbrojtje prej Teje nga
të gjitha të këqijat, (qofshin ato) të përshpe-
jtuara apo të vonuara, ato që unë i diç apo
nuk i diç"*^[6]

E në një hadithë tjetër që gjendet në
"Sahihun e Muslimit" thotë
Pejgamberi,salAllahu alejhi ve sel-elm:
*"Allahu im, ma përmirëso fenë time që
është mbrojtëse e qeshtjës sime, ma për-
mirëso dunjanë time në të cilën jetoj, ma
përmirëso ahiretin tim ku është kthimi im,
bëj që jeta ime të jetë shkak për shtimin e
cdo të mire dhe bëj që vdekja ime të jetë re-
hati prej cdo të keqe"*^[7]

Robi ka nevojë për dua ashtu që ta për-
mirësoj fenë e tij, dunjanë dhe ahiretin e
tij, dhe përmirësimin e tër gjendjes së tij,
thotë Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-
lem, me një dua tjetër: *"...Ma përmirëso
tërë gjendjen time"*^[8]

Ai ka nevojë që të kërkoj prej Allahut, ti
drejtohet dhe ta lus vetëm Atë për të

[2] Muslim(2577)

[3] Transmeton " Buhariu" (7419) dhe "Muslimi" (993).

[4] Nëse Allahu,tebareke ve tealë, dëshiron ti dhuroj dikuj të mira mjafton që vetëm të thotë bëhu dhe ajo bëhet, e njashtu edhe nëse dëshiron dike ta privoj nga ato.(sh.p)

[5] E që në gjuhën arabe u thuhet"Xhevamiu el-Kelim", janë ato fjalë të pakëta por kuptimi i tyre është i gjërë dhe përmbledhës (sh.p)
" el-Musned" (6/134,146)," Sunen ibën Maxheh" (3846), " Sahih ibën Hibban" (869), "el-Mustedrek" (1/521,522)

[6] Albani thote se Hadithi është i Vertet, " es-Sahihā" (1542).

[7] Muslim (2720)

[8] Transmeton ebu Davudi (5090) ndërsa Albani e ka cilësuar si të Mirë në " Sahihu el-Xhami" (3388).

gjitha qështjet, andaj si të shmanget dhe largohet (prej duasë-lutjes)?!

E prej asaj që ka ardhur në fjalët e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, që tregon për mirësin e duasë-lutjes, është ajo që është transmetuar nga ai, salAllahu alejhi ve sel-em, se ka thënë: *"Nuk ka diqka më me vlerë tek Allahu se sa duaja"*^[9] Mjafton ky argumentim për pozitën e madhe, të lartë, dhe fisnike që ka duaja tek Allahu, subhanehu ve teal, është adhurim i madh dhe nënshtrim fisnik-i drejtë, qështja dhe pozita e saj është e lartë tek Allahu, e tër kjo tregon dashurinë që Allahun, subhanehu ve teal, ka ndaj duasë dhe dashurinë e Tij për degjimin e thirrjes së thirrësve, dhe atyre që kërkojnë prej Tij.

E prej mirësive të duasë që janë transmetuar gjithashtu në sunnet, është fjala e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem: *"Njeriu më i paafte është ai i cili nuk bënë dua"*^[10]

Ai i cili lodhët prej duasë me të vërtetë është më i lodhuri; ngase duaja është ibadet edhe nuk kërkon prej pronarit të vetë aktivitet të madhë, nuk e ngarkon atë me lodhje, e as me mund, mundët të lutët duke qenë ulur, duke ecur, e edhe duke qenë i shtrirë: *"I heqin trupat e tyre prej dyshekëve, duke e lutur Zotin e tyre nga frika dhe nga shpresa..."*^[11]

Në të gjitha gjendjët mundë ti lutët Allahut, xhel-le ve ala, e për këtë Pejgamberi, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem e luste Allahun në qdo gjendje; në hyrjen dhe daljen e tij, kur i hipte kafshës me të cilën

udhëtonte, në të ecurit e tij, kur hynte në xhamij, dhe kur dilte prej sajë, në namazin e tij, në qdo gjendje; në ushqimin dhe pirjen e tij, kur i ofrohej grave të tij, në qdo gjendje, salavatullahi ve selamuhu alejhi, e luste Allahun-xhel-le ve ala-

E luste Allahun në çdo vendë në bazë të asaj që përshtatej me të, e për këtë kemi lutje në mëngjes, në mbrëmje, lutje kur flejmë, e edhe kur zgjohemi, lutje gjat namazeve, e edhe kur i plotësonte ato, lutje gjat hyrjes dhe daljes, lutje kur hipte në ndonjë mjet udhëtimi, pra çdo lutje që është vërtetuar nga ai, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, është me një përshtatje të plotë me vendin (kohën) në të cilën thuhet, e kjo na jep të kuptojmë udhezimin e plotë dhe të mirëfilltë të tij, dhe në lidhjen e mirë që kishte me Allahun, subhanehu ve teal, në të gjitha qështjet, e gjithashtu na jep të kuptojmë nevojën e madhe që ka muslimani për dua-lutje për çdo qështje prej qështjeve të tij, dhe për çdo gjendje prej gjendjeve të tij.

Të gjitha ajetet kuranore dhe hadithet e Pejgamberit, sal-lAllahu alejhi ve sel-lem, paraprake tregojnë pozitën e lartë dhe shumë të madhe që ka dua-lutja tek Allahu.

Prof.Dr. AbduRrezak EL BEDER
"Fikhu ed-Dua"ë

Përshtati: Bali SADIKU
Medinel Arabia Saudite

[9] Transmeton Tirmidhiu (3370), ibën Maxheh (3829), ibën Hibbani (870), Hakimi në "el-Mustedrek" (1/490), dijetari i madh Albani, rahimehullah, e ka cilesuar si të mirë në "Sahih el-Edebu el-Mufred" (549).

[10] Transmeton Buhariu në "el-Edebub el-Mufred" (1042), ibën Hibbani në Sahihun e tij (4498), Taberaniu në "el-Muxhemu el-Evset" (5591), ndërsa dijetari i madh Albani, rahimehullah, e ka cilesuar si të vërtetë, mevkuf dhe merfu (i ndalur tek sahabiu e njashu edhe i ngritur deri tek pejgamberi, salAllahu alejhi ve sel-lem), në "es-Sahiha" (601).

[11] Suretu es-Sexhdeh: 16.